
BULETIN INFORMATIV

Janar 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Janar, 2024

Përmbajtja

Kryesia e Akademisë së Shkencave uron, në ditën e lindjes, shkrimtarin dhe akad.	
Ismail Kadare: jetë të gjatë, shëndet të mbarë, art e mendim të pashtershëm	5
Viti 2024 - Vit i Gjuhës Shqipe.....	7
Themelohet çmimi i veçantë shkencor "Pilika" për nxitjen dhe vlerësimin e kërkimeve shkencore në matematikë dhe shkencat kompjuterike	10
Nazim Gruda merr vlerësimin "Investigador distinguido" nga Universiteti Politeknik i Kartagjenës (Spanjë)	12
Redaksia vendore e "Enciklopedisë shqiptare" vlerëson punën e vitit 2023 dhe parashikimet për kalendarin e këtij viti.....	14
Takime pune në Kryesinë e ASHSH për vijimësinë e punës të administratës	16
Mbledhje e zgjeruar e Kryesisë së ASH për organikat, strukturat dhe përbërjen e instituteve të albanologjisë, njësi të reja kërkimore-shkencore pranë saj	17
Reforma në Akademi - frikë apo siguri?	19
Në 80-vjetorin e shkrimtarit Fatos Kongoli, anëtar i Akademisë së Shkencave:	24
Botimet "Toena" dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë - veprimtari për të gëzuar e festuar bashkë dhe në nderim të jubilarit Kongoli.....	24
Takim i Kryesisë së Akademisë së Shkencave me drejtuesit e instituteve të albanologjisë, njësi të përhershme të kërkim-studimit pranë saj.....	27
Ceremonia e shpalljes së çmimeve fituese	29
Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt ceremonia për çmimin e veçantë "Shuteriqi", që akordohet për botimet dokumentare-burimologjike më të suksesshme, për historinë, gjuhën, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin shqiptar.....	32
Çmimi i dytë jepet për veprën "Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike, botim kritik i dorëshkrimeve", me autor akad. Matteo Mandalà (bot. "Ombra GVG")	37
Çmimi i parë jepet për veprën "Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shekullit XIV, me shtesat deri më 1469" me autore Lucia Nadin	41
Në 80-vjetorin e lindjes së shkrimtarit akademik Fatos Kongoli	48
Takim këshillues i Kryesisë me drejtorët e instituteve të albanologjisë dhe kryetarët e komisioneve të përhershme.....	53

Shpallet Konkursi për për ringritjen e Akademisë së të Rinjve dhe për pranimet e reja sipas Ligjit e Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	55
Takim në ASHSH i komisionit të posaçëm të ngritur nga Kryesia e ASHAK-ut për themelimin e Akademisë së të Rinjve të Kosovës	56
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike sot në raportimin e veprimtarisë vjetore	58
Takim në Kryesinë e ASHSH i kryeredaktorëve të revistave periodike dhe të përmbledhësve - tribuna shkencore të instituteve të albanologjisë.....	62
U bë paraqitja e periodikëve shkencorë “Iliria” dhe “Monumentet”, të vitit 2023.....	65
Lectio magistralis "Ndërthurje" nga prof. asoc. dr. Gjergj Prevazi.....	68
In memoriam	70
Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton me nderim e mirënjohje akademikun Eduard Sulstarova -10-vjetori i ndarjes nga jeta.....	71

Kryesia e Akademisë së Shkencave uron, në ditën e lindjes, shkrimtarin dhe akademikun Ismail Kadare: jetë të gjatë, shëndet të mbarë, art e mendim të pashtershëm



Në vitin 1954, plot para 70 vjetësh, Ismail Kadare botoi librin e tij të parë, "Frymëzime djaloshare". Prej shtatë dekadash ai krijon art cilësor për bashkëkohësit e vet dhe për kohërat e ardhshme.


Ismail Kadare është shkrimtari më i njohur shqiptar i të gjitha kohërave. Vepra e tij përkthehet e studiohet si letërsi europiane e botërore në të gjitha kontinentet, që nga Australia, Japonia e SHBA deri në metropolet europiane.

E lexuar tashmë në mbi 50 gjuhë të Botës, kjo vepër konsiderohet fenomen letrar bashkëkohor botëror në letërsi dhe ka fituar çmimet më të rëndësishme letrare kombëtare e ndërkombëtare në Francë, në Britaninë e Madhe, në Spanjë e Itali, në Izrael, në Korenë e Jugut; dhe është nderuar me mirënjohje e me tituj nderi (doctor honoris causa) thuajse në të gjitha vendet e Ballkanit.

Në universitetet europiane dhe në një shkallë më të gjerë albanologjisë i janë shtuar tashmë si një nëndegë më vete studimet në kadareologji, si studime për letërsinë shqipe,

për identitetin shqiptar dhe për raportet midis letërsisë dhe pushteteve.

Vepra letrare e tij, megjithëse me tre botime të plota në Tiranë, dy në Francë dhe një në Prishtinë, ribotohet çdo vit në vëllime më vete dhe autori mban takime të rregullta me lexuesit.



Kadareja është shkrimtari që u ka dhënë liri për dekada me radhë brezave të mëparshëm që jetuan në një kohë kontrolli të përgjithshëm. Letërsia e Kadaresë, për brezat që u formuan në një kohë tjetër, ishte një botë alternative, ku mund të arratiseshe pa druajtje nga ndëshkimi.

Ismail Kadare shkroi një vepër me të cilën krijoi një Shqipëri europiane, më të bukur se ajo që ishte dhe kjo që është sot; një Shqipëri aristokratike, Shqipërinë më të bukur krahasuar me atë që shihet në pasqyrë të historisë dhe në çdo pasqyrë tjetër.

Dekada më parë kritika sovjetike e pati qortuar Kadarenë se e fabrikoi Shqipërinë e tij si një Shqipëri metropolesh, të oksidentalizuar.

Kadare është tashmë më shumë i Botës se i vatrës: shqiptar e european, european e botëror. Shqipërinë e kanë dashur në letërsi e studime në pamjen provinciale, kanunore, tribale. E duan dhe sot ashtu. Kadare ua ka hequr këtë kënaqësi me veprën e tij.

Gëzuar ditëlindjen Ismail Kadare, krenaria e botës shqiptare. Jemi të lumtur që bashkëjetojmë në shekullin e artit tuaj.

Viti 2024 - Vit i Gjuhës Shqipe

Takim i akad. Skënder Gjinushit, kryetar i ASHSH, me znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Arsimit dhe Shkencës

Të pranishëm studiues të gjuhës shqipe të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë ASHSH dhe anëtarë të komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe letërsisë



Akad. Skënder Gjinushi tha në hyrje të takimit se ky bashkëbisedim për gjuhën shqipe sot në universitete e në sistemin arsimor në tërësi është i mirëpritur.

Shpallja e vitit 2024 si vit i gjuhës shqipe është një arsye plus për të shtuar vëmendjen ndaj saj dhe për të ndërmarrë nisma shkencore të reja, që, nga ana jonë, u shtohen tre projekteve madhore në albanologji: "Fjalorit të madh të shqipes", që është në vitin përmbyllës; "Historisë së shqiptarëve", që është dorëzuar për redaktim; dhe "Enciklopedisë shqiptare", që tashmë është në fazë pune. Në këto tre projekte, në redaksi e si bashkautorë, janë të përfshirë mbi 200 studiues (vetëm nga Shqipëria dhe pa bashkëpunëtorët). Si një nga institucionet propozues, e vlerësojmë nismën për shpalljen e Ditës së Alfabetit (22 nëntor) si festë zyrtare që bashkon shqiptarët.

Znj. Ogerta Manastirliu theksoi se vendimi për "Vitin e Gjuhës Shqipe" është marrë pikërisht për të rritur përgjegjësinë ndaj gjuhës amtare në të gjitha nivelet e arsimit, duke

filluar prej programeve (kurrikulave), teksteve, mësimdhënësve dhe nxënësve e studentëve. Jemi në përpjekje për një plan veprimi të gjerë, na duhet bashkëpunimi i ASHSH dhe i instituteve të saj, i universiteteve, i qendrave albanologjike jashtë vendit.

Në takim u bënë propozime të vlefshme që Viti i Gjuhës Shqipe të mos mbetet në një nivel nderimi simbolik, por të jetë vit pune për ndryshime pozitive.

Znj. Manastirliu tha se ky do të jetë vit konkurrimesh kombëtare për shqipen, vit i shkollave verore të rikualifikimit të mësuesve, vit për nisma të përbashkëta për hartim tekstesh të njësuara.



U shtrua problemi i rritjes së përgjegjësisë shtetërore për gjuhën, i nevojës për hartimin dhe miratimin e një ligji për përdorimin e shqipes në funksionet publike (K. Jorgaqi), për redaktorët e shqipes në institucione (S. Mansaku); për ngritjen e një strukture për njësimin e terminologjisë (A. Jubani), e cila, me rreth 40 fjalorët e botuar nga ASHSH, nuk pasqyron gjendjen e sotme, sepse janë botuar herët, dhe ndërkaq është detyrim ndaj kapitujve të anëtarësimit në BE, posaçërisht ndaj "acquis communautaire" (vendet e pranuar tashmë kanë dëshmuar përvoja të mbara e të dështuara); u theksua se roli i inteligjencës artificiale në këtë proces varet shumë nga baza e të dhënave që ka vënë në dispozicion mendja njerëzore.

Propozime u bënë për ridaljen në shtyp të revistave të specializuara si "Gjuha jonë" dhe "Gjuha dhe letërsia në shkollë" (V. Memisha); për rivendosjen e gjuhës dhe letërsisë shqipe në peshën e merituar në kushtet e rrudhjes së vendit të tyre në programet shkollore krahasuar me gjuhët e huaja dhe letërsinë e huaj (A. Omari, B. Qose); që gjuha

shqipe të jepet në shkolla jo si teori, por si për përdorues (T. Toska, Sh. Rrokaj); që dija shkencore të shërbehet me sukses si dije didaktike (T. Plangarica); që të mbështetet mësimi i shqipes në katedrat e albanologjisë jashtë (B. Suta); për nevojën e librit të mësuesit, doracakëve metodikë, për një rregullim më të studiuar të hartimit të teksteve etj.



Akad. Gjinushi, në mbyllje të këtij bashkëbisedimi, duke rikonfirmuar mbështetjen për nismat e MAS për të ndryshuar pozitivisht mësimdhënien e saj në universitete, theksoi se ky duhet të jetë një kujdes i shkallëshkallshëm, që lidhet me stadin e shqipes sot, si gjuhë që po shuhet (në brezat e emigrantëve që kanë lindur e formohen jashtë vendit); si gjuhë për t'u mbrojtur e inkurajuar (tek arbëreshët e gjetkë) dhe si gjuhë amtare me përdorim të njësuar.

Në përfundim u ra dakord që mendimet e shprehura të sistemohen me shkrim si një dokument që do të shërbejë për të programuar bashkëpunimin në vijim.

Themelohet çmimi i veçantë shkencor "Pilika" për nxitjen dhe vlerësimin e kërkimeve shkencore në matematikë dhe shkencat kompjuterike

Në 100-vjetorin e lindjes së akademikut Petraq Pilika, themelues i shkollës shqiptare të matematikës, themelues i së parës katedër të matematikës dhe drejtues historik i saj për mbi tri dekada; bashkëthemelues i shkencës së informatikës; anëtar i Akademisë së Shkencave që nga themelimi; përfaqësues i kësaj fushe dije në kongrese ndërkombëtare.



Çmimi u themelua me vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, me propozim të komisioneve të përhershme të matematikës dhe informatikës, në përputhje me rregulloren për çmimet shkencore që jepen nga ASHSH.

Shkallët e këtij çmimi, kriteret, si dhe kalendari i zhvillimit të konkursit do të njoftohen së shpejti.

Pak fjalë për themeluesin dhe drejtuesin historik të katedrës së matematikës në Shqipëri dhe bashkëthemeluesin e shkencës së informatikës akad. Petraq Pilika (1924-2009), me emrin e të cilit do të jepet ky çmim i veçantë

Petraq Pilika është matematikan, profesor, akademik, Mësues i Popullit. Lindi në Korçë, ku kreu liceun kombëtar francez. Mori pjesë aktive në lëvizjen antifashiste nacionalçlirimtare që në fillimet e saj dhe më pas edhe në luftën antifashiste. U diplomua në degën e matematikës të Universitetit "Lomonosov" të Moskës (1946-1951). Më 1951 u emërua përgjegjës i katedrës së matematikës e të fizikës në Institutin e Lartë Pedagogjik të Tiranës. Me themelimin e UT u emërua përgjegjës i katedrës së matematikës në Fakultetin e Shkencave Natyrore, të cilën e drejtoi për 31 vjet.

Petraq Pilika kreu studime të rëndësishme në fushën e teorisë së funksioneve,

botuar në revista të vendit e të huaja. Në vitet 1970 luajti rol kryesor në hartimin e strategjisë së zhvillimit në matematikë. Ishte organizator kryesor i dy konferencave kombëtare për matematikën (1984, 1989). Nxiti kërkimin e mirëfilltë shkencor dhe e orientoi drejt në hapat e parë të tij në disa fusha me perspektivë për rritjen e nivelit shkencor të mësimdhënies dhe për zbatime në fusha të tjera.

Disa nga veprat kryesore: "Funksionet kufitare e klasat Hp" (monografi); "Teoria e funksioneve të ndryshorit real"; "Teoria konstruktive e funksioneve".



Akad. Petraq Pilika ka qenë përfaqësues i Shqipërisë në disa forume shkencore ndërkombëtare dhe pjesëmarrës në kongreset botërore të matematikës. Ai ka përfaqësuar Akademinë e Shkencave në simpoziumin ndërkombëtar të kërkimeve në këtë fushë zhvilluar në Rumani në vitin 1965 (botuar në *Studii si cercetări matematice*, vol. 17, issues 6-10, p. 994 et cont., bot. Institutul de Matematică; si dhe në *Revue roumaine de mathématiques pures et appliqués*, nr. 10/1965 (edit. Academia Republicii Populare Romîne); në konferencën ndërkombëtare të matematikanëve në Helsinki më 1982 (botuar në *Proceedings of the International Congress of Mathematicians*, Helsinki 1980, edited by Olli Lehto - "Mathematics" - vol 1, p. 36; si dhe në *Les lettres Albanaises*, 1981.

Nazim Gruda merr vlerësimin “Investigador distinguido” nga Universiteti Politeknik i Kartagjenës (Spanjë)



Universiteti Politeknik i Kartagjenës (La Universidad Politécnica de Cartagena-UPC) vlerëson akademikun shqiptar Nazim Gruda me cilësimin "Investigador distinguido".

Përzgjedhja e tij vjen pas thirrjes së Ministrisë së Universiteteve të Spanjës, përmes projektit të titulluar "Modernizimi dhe dixhitalizimi i sistemit arsimor", në kuadër të planit të rimëkëmbjes, transformimit dhe reziliencës të shkencës dhe arsimit të lartë, për thithjen e shkencëtarëve më të talentuar nga Europa.

Kjo përzgjedhje i mundëson akad. Grudës të vijojë studimet dhe bashkëpunimin me UPCT, bashkëpunim ky me një histori disavjeçare, që përfshin projekte kërkimore dhe botime të përbashkëta. Në vitin 2021, ai ishte edhe ligjërues në kuadër të shkëmbimeve Erasmus.

Universiteti Politeknik i Kartagjenës është universiteti teknik më i ri në Spanjë, edhe pse disa nga shkollat e tij u themeluan në fund të shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të. UPCT është pjesë e shoqatës UP4 së bashku me Politeknikën e Madridit, Katalonjës dhe Valencias.

I njohur gjerësisht për studimet e tij në hortikulturë dhe si specialist në substratet bimore, akad. Gruda do të luajë një rol kyç në projektin për zhvillimin e hortikulturës urbane dhe "vertical farming".

Akad. Gruda, autor i mbi 300 punimeve shkencore, prej të cilave 100 në Scopus, renditet si kërkues me punime me një indeks citimi shumë të lartë (highly cited, me 1 për qind për disa prej artikujve shkencorë në Web of Science).

Edhe në vlerësimin e kryer nga ekspertët e Universitetit të Stanfordit në SHBA vitet e fundit ai renditet në 2 për qind të shkencëtarëve më me ndikim në "World's Top 2 per cent Scientists"; ndërsa sipas indeksit-h të "Google Scholar" për hortikulturën, në 10 shkencëtarët më të suksesshëm të Europës.

Redaksia vendore e "Enciklopedisë shqiptare" vlerëson punën e vitit 2023 dhe parashikimet për kalendarin e këtij viti

Në mbledhjen e sotme redaksia vendore e "Enciklopedisë shqiptare" vlerësoi se miratimi i akteve ndërqeveritare, ndërakademike e nënligjore dhe i atyre të njësitimit të standareve teknike e profesionale është një arritje bazike.

Redaksitë e ngritura mbështetur sipas kufijve të disiplinave në 27 fusha të dijes dhe vënia e tyre në funksionim; ndërveprimi mes tyre dhe redaksive gjegjëse të Kosovës; ngritja e një redaksie të posaçme koordinuese për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut; janë disa arritje të tjera të vitit të shkuar. Redaksitë e të tre niveleve janë tashmë në punë të drejtpërdrejtë.



Disa nga redaksitë e fushave: e letërsisë, e gjeografisë fizike dhe e asaj humane, e arsimimit, e ekonomi-financës dhe e biologjisë, kanë hartuar listën paraprake të fjalëve-referencë, emërtime të përveçme e të përgjithshme (fjalësi, lexicon-i, emërtesa); një pjesë tjetër janë në përfundim.

Stabilizimi i fjalësit, i mbështetur në bazën e të dhënave të FESH dhe të FEK, si dhe të enciklopedive krahinore e tematike, është një proces i dyfishtë: "collect and select". Deri në fund të muajit mars 2024 do të jetë mbyllur.

Gjatë muajit janar do të organizohet një bashkëbisedim instruktues me gjithë anëtarët e redaksive të fushave, me pjesëmarrjen e redaksisë së posaçme të MV.

Kryeredaktori i "Enciklopedisë shqiptare" akad. Skënder Gjinushi tha në këtë takim se tre projektet e mëdha në albanologji: "Historia e shqiptarëve", "Fjalori i madh i shqipes" dhe "Enciklopedia shqiptare", provuan paraprakisht karakterin progresiv të reformës institucionale; bashkimi funksional ndodhi para bashkimit formal. Suksesi i dy nismave të para jep siguri edhe për suksesin e ESH. Redaksia vendore duhet të kryejë detyrën e vet sipas ndarjes së përgjegjësive të anëtarëve të vet ndaj redaksive të grup-fushave.



Takime pune në Kryesinë e ASHSH për vijimësinë e punës të administratës

Pas rikonfirmimit të punonjësve kërkimorë-shkencorë të instituteve të albanologjisë - takime pune në Kryesinë e ASHSH për vijimësinë e punës të administratës në përputhje me VKM nr. 821 datë 28 dhjetor 2023 për ngritjen e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji, i cili u publikua sot në Fletoren Zyrtare dhe hyri në fuqi.

Punonjësit e administratës ndihmëse (shërbimet paralele të ASHSH dhe të instituteve të albanologjisë: botime, biblioteka, arkiva; financë, marrëdhënie publike e me jashtë) sot në bashkëbisedime të pavarura me Kryetarin e ASHSH akad. Skënder Gjinushin. Morën pjesë gjithashtu zëvendëskryetari i ASHSH akad. Vasil S. Tole, kancelari dhe përfaqësues të grupit të punës për ribashkimin nga institutet e albanologjisë.



Qëllimi: njohja me ndryshimet administrative që burojnë nga aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Asamblesë së ASHSH, më 31 maj dhe 28 dhjetor të vitit 2023; me rritjen e frytshmërisë së punës të sektorëve mbështetës; me riorganizimet e nevojshme në këtë funksion.

Takimet i shërbyen thellimit të njohjes së kuptimit dhe rëndësisë së reformës; marrjes së përgjegjësive për të bashkëcur me ritmet që ajo kërkon; duke respektuar si autonominë e njësive të reja të përhershme sipas ligjeve në fuqi, ashtu dhe rirregullimin administrativ-institucional në një rrjet të njësuar kërkimor akademik.

Mbledhje e zgjeruar e Kryesisë së Akademisë së Shkencave për organikë, strukturat dhe përbërjen e instituteve të albanologjisë, njësi të reja kërkimore-shkencore pranë saj

Të pranishëm anëtarët dhe drejtuesit e grupeve të punës të ngritur nga Kryesia për konfirmimin në detyrat që kryejnë të punonjësve kërkimorë-shkencorë.

Stabilizimi afatgjatë i strukturave të instituteve do të këshillohet, siç parashikohet në Statutin e ASHSH, përgjatë periudhës janar-tetor 2024, me drejtuesit dhe këshillat shkencorë të tyre dhe me anëtarët e Asamblesë.



Mbledhja u drejtua nga akad. Skënder Gjinushi, i cili falënderoi grupet e punës për vlerësimin e kujdesshëm dhe objektiv të punonjësve kërkimorë-shkencorë të instituteve të albanologjisë, që do të vazhdojnë normalisht punën në fushat e tyre të kërkimit. Me miratimin e organikave dhe të strukturave të tyre, vijuar me emërimet në detyrë, që do të bëhen brenda javës, do të mbyllet faza e parë e integrimit, por periudha kalimtare do të vazhdojë edhe gati një vit, në mënyrë që efektshmëria e punës vetjake dhe institucionale të jetë sa më e lartë.

Akad. Gjinushi theksoi se me ribashkimin e instituteve të albanologjisë vetë institutet rifituan status të ligjshëm e funksional dhe Akademisë iu rikthye një e drejtë e përgjegjësi që lidhet me aktin e themelimit të saj, për të kryer para së gjithash misionin e një kryeqendre të albanologjisë jo vetëm brenda vendit.

Në vijim ai theksoi që ka çështje të cilat mund të zgjidhen menjëherë dhe të tjera që kanë të bëjnë me ndryshime më thelbësore, që sigurojnë fuqizimin e kërkimeve në disiplinat e albanologjisë dhe që lidhen me strategjinë e vetë Akademisë.

Akad. Gjinushi paraqiti në këtë mbledhje projektvendimet për strukturat, organikat dhe përbërjen nominale të trupave akademike dhe tekniko-shkencore e ndihmëse të njësive të reja albanologjike dhe ftoi të pranishmit për diskutim. U bënë propozime të dobishme për emërtimin e departamenteve ekzistues; për shtimin e nënstrukturave të nevojshme dhe për saktësimet e objektit të tyre referuar termave të disiplinës dhe periudhizimeve të gjithëpranuara; për nevojën e formimit dhe specializimit në nëndisiplinat e ngushta dhe për gjuhët e rralla. U theksua se strategjitë duhen ndërtuar duke ngritur struktura kërkimore prospektive, pa pritur krijimin e specialistëve të munguar.



Në këtë diskutim kontribuan prof. dr. Paskal Milo, akad. Adem Bunguri, prof. dr. Josif Papagjoni, prof. dr. Afërdita Onuzi, akad. Valter Memisha dhe të tjerë të pranishëm.



Reforma në Akademi - frikë apo siguri?

Dy përvoja në krahasim: me shkas nga takimi në kryesinë e Akademisë së Shkencave

Prof. dr. Josif Papagjoni

I ftuar në një mbledhje të zgjeruar të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, teksa u diskutua procesi i shkrirjes së strukturës së ish-Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) në strukturën e Akademisë së Shkencave, një mori retrospektivash ia behën sakaq në mendjen time.

Nga kujtesat më të dhimbshme që pata asoherë, si njeri që kam punuar një jetë të tërë në njësitë e saj shkencore e jam pensionuar aty, ka qenë reforma e vitit 2007.

Sot jemi në një tjetër reformë. Po ku është dallimi? Duket menjëherë ku. Është ruajtja e strukturës së hershme të saj, pa e cenuar. Pra, ka gjithsesi një kujdes, një vëmendje, duke ruajtur sa vijimësinë e fushave studimore, aq dhe personelin. Punonjësit nuk janë të tmerruar se po humbin vendet e punës, si në vitin 2007. Ky ndryshim është paralajmëruar më herët. Ka mendime të ndryshme, por peshorja anon, me sa duket, nga ky bashkim.



Unë e vlerësoj mënyrën se si po bëhet ky bashkim, më së pari për gjithë ata punonjës që, sa herë flitej për reformë, menjëherë u futej frika në bark dhe lindte një panik i madh kush e kush të ruante vendin e punës. Kjo përket me pasionin e tyre, më së pari, pastaj dhe me mbijetesën.

Në këtë mbledhje, të kryesuar nga kryetari i Akademisë së Shkencave Skënder Gjinushi, ku qenë disa nga profesorët e nderuar të studimeve albanologjike, si Paskal Milo, Marenglen Verli, Valter Memisha, Adem Bunguri, Neki Frashëri, Afërdita Onuzi; si dhe anëtarët e Kryesisë Shaban Sinani, Vaso Tole etj., paçka se ishin pikërisht ata që shqyrtuan dosjet e çdo instituti dhe të çdo punonjësi, nuk kishin në dorë thika dhe hanxharë. Kishin ardhur me zemër, jo vetullngrysur për të prerë me një majë lapsi trupat e njësive shkencore albanologjike. Jo! Dhe e para gjë që dua ta them është pikërisht qasja humane e kësaj reforme, përgjegjësia për të ruajtur strukturat, organikat; vizioni për të shquar identitetet dhe specifikat e gjithë njësive akademike që vijnë nga ASA. Duket si pa rëndësi, por them se kjo është nga më thelbësoret për ata që punojnë në ato institute.

Kujtoj se si një mori hanxharësh ranë mbi trupat e brishtë të instituteve albanologjike në reformën e vitit 2007. Ata hanxharë prej njerëzish cinikë, mburravecë dhe të pamëshirshëm, prenë pa mëshirë gjymtyrë jetike të instituteve të dikurshme, të cilët qenë me 30, 40 e 60 punonjës secili. Gjithë ç'qenë trashëguar me mundim u katandisën të gjithë së toku diku tek 120 punonjës nga afërsisht 500 që ishin dikur. Reformë mund ta quash këtë? Bah! Ishte një thertore, jo reformë. Thertore e denjë për ata që nuk e donin shkencën shqiptare, veçmas albanologjinë. Që hiqeshin si moderatorë, por s'qenë veçse ca snobë e cinikë, që talleshin me ndjeshmëritë dhe aspiratat shkencore të të tjerëve.

Asohere unë isha drejtor i Qendrës së Studimeve të Artit, e cila u shkri me tërësej dhe nga 12 punonjës u katandis në katër, ndërsa vetë ky institucion u përfshi në amalgamën "Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit". Më kanë mbetur në sy fytyrat e shqetësuara të punonjësve që u shkurtuan. Njëri syresh madje, studiues i talentuar i muzikës (sot nuk jeton më, ndjesë pastë!), më lutej me lot në sy t'i telefonoja njërit prej "reformatorëve", që u bë më pas ministër, Myqerem Tafajt, se medemek ai i pat premtuar që do të rrinte aty dhe tërci-vërci. Gënjeshtër të gjitha. Ne vetë atëherë, edhe pse ishim profesorë, u detyruam të përmbushnim ca formularë pasi do të rekrutoheshim si punonjës të rinj shkencorë të një institucioni tjetër, që u quajt Qendra e Studimeve Albanologjike. Pra, nuk do të ishim më ata që kishim qenë, por të tjerë. Eh, me këto hile të njohura pushtetarësh për të përlligjur shkurtimet dhe shmangien nga revokimet gjyqësore, nuk ia hiqnin dot lotët atij burri, me fëmijë të porsalindur, që më lutej e përgjerohej mua ta mbaja në punë. Por unë s'kisha veçse "çelësat e kashtës".

Natyrisht një reformë, kur lipset, ka dhe shkurtime, riorganizime, por në studimet e botës shqiptare (apo "albanologji", siç quhet), ç'dreq shkurtimesh duheshin bërë?! Ajo ishte katandisur kokoshi një thellë, siç thoshte fjala. Thelbi ishte një dhe vetëm një: shkurtimi i organikave. Pastaj, për t'i paraqitur gërshërët e ndryshkuara për qethjen e kopesë së deleve të bindura si bisturi kirurgjikale për operime lezionesh të infektuara, shpiket fjala marramendëse reformë. Boll më me shkurtime. Plotësime, po, duhen bërë

nëse ky shtet do që këtij populli të vogël e të vonuar në histori t'i qitësh në dritë ndoca visare identitare që ka e me të cilat vetëshprehet: arkeologjinë, gjuhën, historinë, antropologjinë, letërsinë, artet, gjeografinë, mendimin politik, mobilitetin e strukturës sociale etj!



Qendra e Studimeve të Artit dhe Instituti i Kulturës Popullore ishin dy identitete krejt të veçanta që u vunë në thertoren e 2007-ës, dhe nga barku i tyre lindi një hibrid. Rithemelimi së fundmi i kësaj Qendre të Studimit të Arteve si njësi më vete, brenda strukturës së Akademisë së Shkencave, është rivënia në vend e një të drejte të cenuar nga mendimi opak i asaj kohe dhe i atyre njerëzve, që e kryen atë kinse reformë.

Arti ka qenë dhe mbetet një nga pushtetet e mëdha të mendjes dhe shpirtit, një nga kënaqësitë dhe përkëdhelitë estetike më të rafinuara, sikundër, po ashtu, mbetet një nga shenjat mëvetësuese të talentit dhe shpirtit kombëtar, filigrana e vetë këtij shpirti. Arti është më tutje se kaq. Është një katedër e madhe e përpunimit të situatave më të thella psikike të njeriut, të shoqërisë shqiptare dhe gjerazi të popullit, kombit, duke pasur ngaherë një impakt të fortë publik për vetë natyrën e tij të ekspozimit dhe perceptimit. Nga këto arsye dhe të tjera, unë u gëzova sinqerisht që, më në fund, fitoi një vizion realist, dobiprurës; u gëzova që së shpejti do të ringrihet kjo Qendër e Studimit të Arteve. Dhe këtu dora e përzgjedhjes së studiuesve të rinj duhet të jetë e rreptë, sepse për dreq në kësi rastesh dikush thotë ma fut në punë këtë e dikush fut atë; se ky është djali i atij, vajza e këtij, dhe ja ku shtojmë thjesht ca njerëz që veçse pinë kafe e bëjnë llogje.

Me kaq e mbylla merakun tim si studiues i arteve. Tani disa mendime të miat, ngacmuar nga kjo mbledhje. Shkrirja që po bëhet, apo siç njëri e tha me humor, martesë midis dy akademive, do të kërkonte kujdesin e një mamie. Kur them mamie, metaforën do ta dekriptoja më së pari te lindja e këtij statusi të ri, mëpastaj te torta që u përket nga

buxheti njësave shkencore albanologjike.

Qysh kur u krijua Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 1972, nordi i saj qenë studimet albanologjike. Raketa nuk bëhen dot, as hidrocentrale. Mund të jemi thjesht aplikantë. Por në studimet albanologjike mund dhe duhet të jemi të mëvetshëm duke i dhënë tonin. Vetëm kështu kjo Akademi mund të funksionojë në një shtet e popull të vogël si yni, i cili ka nevojë të dëshmojë vetveten para të tjerëve, që shpesh kanë qenë edhe grabitqarë të vlerave tona. Dhe një synim i tillë brendësohet në mënyrë integrale pikërisht nga studimet arkeologjike, historike, gjuhësore, letrare, antropologjike, kulturës dhe artit etj. Tri projektet e mëdha kombëtare: Enciklopedia Shqiptare me 10 vëllime (që ka zënë udhën e mbarë), Fjalori i Gjuhës Shqipe dhe Historia e shqiptarëve, të financuara nga Qeveria, janë një thellë dhe sofër e madhe ushqimesh që ose të mbyt, ose të përtërin. Besoj se të tre këta projekte do t'u japin njësave albanologjike dhe gjithë studiuesve një synim të mbrothët apo, me pak humor, një drekë të pasur. Dhe, meqë jemi te projektet, shpirti përtëritës i mendimit akademik janë botimet, librat.

E dyta, identifikimi, plotësimi dhe ardhmëria e njësave studimore brenda instituteve, departamenteve etj. Një mendim të vyer sollti në diskutimin e tij, bie fjala, studiuesi i njohur Paskal Milo, nëse duhet, për shembull, të ristrukturohet njësia studimore e historisë së antikitetit të vonë, të cilën e ka Instituti i Arkeologjisë. A mund të zhvendoset ajo tek Instituti i Historisë? Është një çështje që ha diskutim. Me dijen time të kufizuar, unë gjykoj se kjo fushë studimore duhet t'i shkojë historisë, çka kërkon hulumtime serioze dhe mbështetje financiare me studiues të rinj, të cilët njohin gjuhët e vjetra (greqishten e vjetër, latinishten etj.). Sa pak i njohim burimet e kësaj periudhe, kredhur në nebulozat e padijes sonë, që mund të rrinë strukur nëpër arkivat e Vatikanit, Venecias, Kostandinopolit. Natyrisht po kjo periudhë mund të studiohet fare mirë edhe nga arkeologjia, veçse ndryshojnë optikat: nëse arkeologjia studion kulturën materiale të kësaj epoke me gjithë zbulimet dhe interpretimet e brendashkruara; historia rrëmon te ngjarjet, proceset politike shoqërore, personalitetet, format shtetërore, luftërat, dokumentet etj. Më në fund ka ardhur koha që sytë e historisë të drejtohen te kjo periudhë, për të konfirmuar në vijimësi a, ndoshta, në themeli, gjenezat dhe formësimet tona etno-kombëtare. Ose ideja tjetër, po për historinë, për një identifikim më të qartë të objektit studimor, që do të ingranonte më mirë departamentin e studimeve të Mesjetës, Rilindjes Kombëtare (si periudhë më vete) dhe historisë së pasthemelimit të shtetit shqiptar, çka kërkon një identitet më të qartë kohor.

I një kahu të ngjashëm ishte, për shembull, edhe një mendim i hershëm që është vërtitur përherë mes nesh: a duhet që studimet letrare të jenë njësi e Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë apo të dalin më vete, ose, mbase, të bashkohen me artet dhe të krijojnë një institut më vete. Unë kam qenë dhe mbetem i idesë se letërsia dhe artet janë në përbashkësi dhe harmoni njëra me tjetrën, para së gjithash sepse specifika e tyre është e

përbashkët: estetike. Nga ana tjetër, letërsia është bërë dhe bëhet përherë ushqim i shumë arteve: teatri ka dramën dhe komedinë, kinematografia ka skenarin (herë origjinal, më shumë i huajtur nga letërsia, romanet, tregimet), muzika dhe koreografia kanë poezinë, libretin (opera, kënga, kantata, baleti). Letërsia është më pranë arteve sesa pranë gjuhës. Gjuha është po njësoj e rëndësishme edhe për letërsinë edhe për historinë, publicistikën, shkencën, arsimin, aktet juridike administrative etj. Ndofta gaboj, por shkrimet e hershme biblike nga Meshari i Buzukut e këndeje, le ta quajmë letërsi biblike falë së cilës qëndrohet fort si njësi ndërvepruese unike mes gjuhës dhe letërsisë, sot më duket e kapërcyer, paçka se më parë ky njësim shënjonte nevojën dhe argumentin e fillesave tona albanologjike. Letërsia është fiction, ka trillin dhe sendërgjimin, sikundër prodhimin e kënaqësisë estetike. Pra, diçka e lidhur thelbësisht me gjithë artet, jo me narrativën fetare; ka edhe objektin e përbashkët si dukuri estetike, edhe ndërkomunikimet gjinore siç përmendëm më sipër.

Shkurt, mendimet që do të rrihen nesër në dobi të ndërlidhjes, përplotësimit dhe funksionalitetit të njësive studimore albanologjike duke barabatur fusha, objekte, periudha të ndryshme, do të sjellin gjësende të reja e të frytshme. Në institute të tilla si ai i antropologjisë, specifike e të jashtëzakonshme janë arkivat e vlerave të kulturës shqiptare, ku është sublimuar vetjakësia jonë shpirtërore, zakonore, kulturore, artistike, mjedisore, shkurt fryma e kombit. Mua më duket se këtu duhet ngulur këmbë edhe më shumë në pasurimet e atij fondi të madh në veshje, folklor muzikor, gojor, koreografik, doke e zakone, stoli, zbukurime etj, si dhe lëvizjen në një rrafsh të gjerë antropologjik të mendësisë së popullit e konkretizuar në hapësira historike, të njësitë krahinore, gjer dhe në zona të ngushta. Afërmendsh se duhen qëmtime e studime se si ka ndryshuar kjo kulturë nga shekulli në shekull; ndryshe vishej dikur një fshatar me tirqe a qillota, ndryshe sot me blu xhinse e stof; një herë kishte një kalë, tenxhere bakri dhe vatër zjarri, sot ka makinë, tenxhere e sobë elektrike etj; dikur një kasolle a shtëpi me vatër zjarri në mes, sot apartamente dhe vila. Ndryshojnë rrënjësisht kushtet e banesës, ndryshon mjedisi nga ai rural në atë urban dhe metropolitan etj. Pra, edhe këtë evoluim duhet ta studiojmë, por mos të harrojmë objektin kryesor të këtij instituti: hershmërinë, pjesën tashmë të ngrirë, sigurisht duke freskuar optikat e studimeve të pritshme. Dhe, siç preka vetëm pak gjëra dhe pjesërisht, do të duhet që në këtë shkrim të njësive studimore albanologjike në Akademinë e Shkencave, në periudhën 8-mujore që pason, të shprehen e marrin jetë ide, vizione e mendime të vyera që, shpresoj, të sjellin produkte të mirëpritura.

**Në 80-vjetorin e shkrimtarit Fatos Kongoli, anëtar i Alademisë së Shkencave:
Botimet "Toena" dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë - veprimtari për të
gëzuar e festuar bashkë dhe në nderim të jubilarit Kongoli**

Të premtën, ora 12.30, në sallën "Aleks Buda"

Të mirëpritur miqtë, kolegët (akademikë, shkrimtarë, studiues) në këtë ngjarje festive.

Në vitin 2022 Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi i shkroi Akademisë Suedeze të Shkencave letrën e mëposhtme, në emër të Kryesisë, e cila ishte e ftuar të bënte propozimet e saj, për ta nominuar akad. Fatos Kongolin, shkrimtar me njohje kombëtare e ndërkombëtare, si kandidat për çmimin "Nobel", bashkë me kandidatin tradicional prej më shumë se 30 vjetësh Ismail Kadarenë, të ndjerin Luan Starova, shkrimtar i vetëpërkthyer në tri gjuhë dhe Carmine Abate-n, shkrimtar arbëresh në letërsinë bashkëkohore italiane.



I am honored to present below the nomination for the Nobel Prize competition in Literature.

I nominate the Albanian writer Fatos Kongoli, one of the most prominent authors of contemporary Albanian literature, published and appreciated in our country and abroad. He studied and graduated in mathematics, but since in his careers beginnings he

worked as editor and literary journalist. And in a very short time he devoted his energies totally to creativity work, at first as distinguished story writer and throughout the years of his life as a novelist. Kongoli is the author of 16 novels, many of which have been translated and published in several languages (in France, Italy, Switzerland, Greece, Germany, Great Britain, Spain, Japan, Poland, Slovakia, Serbia and in Esperanto). Many of his novels have been republished.



Festojmë së bashku
80-vjetorin
e lindjes së shkrimtarit
Fatos Kongoli
anëtar i Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë

12
JANAR
2024

Salla "Aleks Buda",
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
ora 12:30

Fatos Kongoli's work immediately attracted the attention and emotions of Albanian and foreign readers, because it reflected the drama of the individual during the dictatorship and transition periods. The citizen's confrontation with the absurdity of life, his inner dramas, the penetration into the psyche of the oppressed humans, the creation of the antihero, contrary to the concept of socialist realism, etc. represent the main creative subjects of Kongoli. The axis of his entire work is the existential crisis of the Albanians during the dictatorship and transition period, which is still presented as insurmountable.

Human paradoxes, irony of past reality and absurd situations, the intention to liberate the traumatized man from his identity crisis, do not turn the novelist Kongoli into a rude writer; on the contrary, by a deep humanistic feeling, his work emphasizes that the salvation of the man comes from the human love. The theme of the absurd in most of his novels, as well as the penetration into the secret part of human soul has led

the French press to describe him as a mixture of Beckett and Dostoevsky. But more noticeable is the parallelism of the Kongolis characters with the philosophy of the absurd in the Albert Camus work.

F. Kongoli's novels are a confirmation of modern Albanian prose, which transcends borders, entering the universe of contemporary world literature. For these essential features Fatos Kongoli has been consistently awarded several prestigious national prizes, as well as international ones, such as the Balkanika International Award (Sofia-Bulgaria, 2002). He holds the title of Grand Master (Tirana 2012) and the title of the Knight of the Legion of Honor (Chevalier de Légion d'Honneur, Paris 2010). The President of France was expressed for Kongoli: My country deeply appreciates the greatness of your work. Literature writing is an art of suffering and loneliness.

Takim i Kryesisë së Akademisë së Shkencave me drejtuesit e instituteve të albanologjisë, njësi të përhershme të kërkim-studimit pranë saj

Akad. Skënder Gjinushi bën të njohura për drejtuesit aktet kryesore ligjore, nënligjore dhe statutore që përbëjnë bazën e reformës së riorganizimit të studimeve albanologjike si kërkime elitare

Ngritja e instituteve të albanologjisë pranë ASHSH, pas ndërprerjes së veprimtarisë së tyre si institucione të arsimit të lartë, jashtë misionit dhe funksioneve për të cilat ishin themeluar, përbën një rregullim në sistem, tha akad. Gjinushi. Me aktet që u miratuan Qeveria zgjidhi një prej problemeve të këtij sistemi, duke u dhënë status të ligjshëm instituteve, me vazhdimin e veprimtarisë së tyre si institute të kërkimit shkencor.



Ribashkimi, theksoi akad. Gjinushi, do të ndikojë për të zbutur fragmentarizimin dhe copëtimin e kërkimit shkencor, çrregullin e të cilit do ta zgjidhë miratimi i ligjit të ri për shkencën, që po hartohet nga disa institucione, duke përfshirë Akademinë e Shkencave.

Tani që aktet themelore të fazës së parë: shtesa në Statut për institutet dhe qendrat e përhershme; konfirmimi i kërkuesve shkencorë në fushat e tyre studimore duke u këshilluar edhe me mendimin e grupeve të punës që u ngritën me ekspertë të jashtëm; miratimi i strukturave dhe organikave, hapja dhe plotësimi i këshillave shkencorë duke rezervuar qartësisht dy të tretat vendimmarrëse për anëtarët e brendshëm; përbëjnë garancitë bazë për liritë dhe autonominë akademike. Nga hapja, theksoi akad. Gjinushi, këto parime vetëm fitojnë fushë më të gjerë zhvillimi. Në komisionet e përhershme pranë

ASHSH, tha ai, më shumë se dy të tretat janë të jashtëm, dhe kjo ka qenë mbështetja kryesore e fuqizimit të veprimtarisë së saj. Edhe projektet themelore në albanologji nuk mund të bëheshin e realizoheshin pa këtë hapje e zgjerim ndërinstitucional.



Kjo është reforma e parë në ASHSH që përmban jo shkurtime e rënie, por synime për rritje, plotësim me ekspertë e fusha ekspertize. Ruajtja e nënstrukturave dhe e drejtuesve të tyre në institute (departamente, sektorë), duke i parashikuar për një periudhë të mëvonshme ndërhyrjet për fuqizimin e tyre, është një tjetër faktor që po i çliron njerëzit nga frika dhe paragjykimet.

Në takim dhanë mendime të dobishme akad. Adem Bunguri, drejtor i Institutit të Arkeologjisë; prof. dr. Hamit Kaba, drejtor i Institutit të Historisë; akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë; prof. asoc. dr. Olsi Lelaj, drejtor i Institutit të Antropologjisë dhe akad. asoc. Stefan Çapaliku, drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve.

Në ditët në vijim, duke filluar nga e premtja, do të bëhen takimet këshillimore me kërkuesit e instituteve dhe mbledhja e bordit të drejtorëve.

Ceremonia e shpalljes së çmimeve fituese

Akad. Adem Bunguri paraqet punën e jurisë çmimit të veçantë “Shuteriqi”

Në ceremoninë e çmimit të veçantë “Shuteriqi” akad. Adem Bunguri në emër të jurisë paraqiti punën e kësaj jurie, nga fillimi deri në shpalljen e çmimeve.

Në vijim të tradicionit vlerësues të botimeve më qualitative akademike dhe në kuadër të përvjetorit të themelimit të shtetit të Arbërit dhe 555- vjetorit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Akademia e Shkencave gjatë vitit të kaluar akordoi çmimin e veçantë vlerësues me emrin e nderuar “Shuteriqi”.

Ky çmim është themeluar me vendimin nr. 40, datë 17.07.2023 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave për botimet dokumentare dhe burimologjike.

Juria e këtij çmimi, e krijuar me vendimin nr. 41 të Kryesisë së ASH, të datës 21. 07. 2023, përbëhet nga 5 anëtarë (akad. A. Bunguri (kryetar), Prof. Ksenofon Krisafi, Prof. asoc. Evalda Paci, Dr. Etleva Domi dhe Prof. Ermal Baze (anëtarë) dhe sekretare teknike znj. Albana Bogdani, sekretare e shkencave albanologjike në ASH.

Në emër të Kryesisë së ASH dhe të Jurisë akad. Bunguri falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në konkursin e çmimit të veçantë “Shuteriqi” si dhe anëtarët e Jurisë për kontributin e tyre të çmuar në finalizimin e tri fazave të këtij konkursi.

Tematika e këtij konkursi fokusohej në botimet dokumentare të panjohura burimologjike që përfshijnë një periudhë prej rreth 500 vjetësh, nga shteti i Arbërit (1210) deri në Kuvendin e Arbërit (1702) dhe ngjarjet që pasuan deri në fund të shek. XVIII. Themelimi i shtetit të Arbërit është bërë i njohur nga mbishkrimi i gurtë i Gëziqit, të cilin e restauroi arkitekti dhe studiuesi Koço Zheku dhe e deshifroi, e interpretoi dhe e botoi akad. Dhimitër Shuteriqi, emrin e të cilit e mban edhe çmimi i veçantë që ndajmë sot. Shuteriqi është studiuesi që jo vetëm e ka deshifruar mbishkrimin e Gëziqit mbi Principatën e Arbërit, por ka studiuar gjithashtu marrëdhëniet e shtetit të Arbërit me principatat feudale përreth tij.

Qëllimi i këtij konkursi ishte vlerësimi dhe inkurajimi i botimeve të reja me karakter dokumentar dhe filologjik, pasi botimi i burimologjisë mbi historinë e shqiptarëve, të kulturës qytetërimit dhe identitetit të tyre, për Akademinë e Shkencave është nevojë shkencore dhe përparësi objektive.

Ka qenë disi e vështirë tërheqja e shumë studiuesve në këtë konkurs, për faktin se numri i botimeve të mirëfillta dokumentare është i kufizuar. Duke filluar nga data 28 korrik 2023 e në vazhdim, juria ka bërë 5 thirrje të njëpasnjëshme studiuesve të fushës për pjesëmarrje në këtë konkurs, thirrje që u shpërndanë në web-faqen dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave. Megjithatë, mungon në prurjet e këtij konkursi ndonjë titull më se i mirëpritur dhe me rëndësi cilësore. Do të kishim dashur që të

paraqitej edhe vëllimi me dokumente të pabotuara mbi mesjetën shqiptare i studiuesit të mirënjohur Injac Zamputi, që me punën dhe shërbimin e tij të jashtëzakonshëm; ka fituar admirimin e studiuesve të disa brezave, të botuara post mortum, nga “Albanisches Institut”.

Gjithsesi, duhet të theksojmë se interesi për pjesëmarrje ka qenë i lartë dhe mjaft prej prurjeve janë vërtetë cilësore. Që në fillim, Juria vendosi që në mbyllje të konkursit, të shpallen dy çmime të dyta dhe një çmim të parë. Gjatë kësaj periudhe mbi 5 mujore (korrik-dhjetor 2023), juria ka studiuar dhe analizuar të gjitha botimet e ardhura në konkurs.

Të gjitha botimet iu nënshtruan verifikimit të hollësishëm dokumentar dhe studimit në elementët kryesor të strukturës dhe përmbajtjes, vlerës dokumentare, burimologjisë, sistemit të referencave dhe në përgjithësi prurjeve të reja shkencore etj. Mbi këtë bazë është ndërtuar tabela e pikëzimit dhe e vlerësimit të çdonjërës prej botimeve të ardhura në konkurs.

Kriteret kryesore të vlerësimit të botimeve të ardhura në konkurs, për të gjitha fazat e konkurrimit, kanë qenë: risitë që sjell vepra, origjinaliteti dhe rëndësia e veprës për fushën e burimiologjisë dokumentare apo atë të studimeve filologjike, vlera dhe kontributi origjinal i veprës për komunitetin shkencor, niveli i analizës dhe sintezës, koherenca dhe kohezioni midis hipotezave, diskutimit dhe përfundimeve, terminologjia shkencore, stili akademik i të shkruarit dhe gjuha e rrjedhshme, bibliografia e përditësuar dhe sistemi referencial, përputhshmëria e citimeve me referencat bibliografike dhe aparati shkencor dhe ai ilustrativ.

Në përputhje me kriteret e mësipërme, juria ka realizuar tabelën e pikëzimit për secilën prej veprave të paraqitura në konkurrim. E pavarur në punën e saj, ajo është munduar të jap vlerësime sa më objektive dhe të motivuara në pikëpamje të vlerës së tyre shkencore dhe historiko-kulturore.

Puna e jurisë ka kaluar nëpër tri faza. Në përmbyllje të fazës së parë të vlerësimit, u përzgjedhën për të vazhduar konkurimin e mëtejshëm botimet e mëposhtme:

1. Gjon Berisha, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu në fondet e arkivës shtetërore të Dubrovnikut”, botim i vitit 2018 (431 faqe dhe 228 dokumente).

2. Matteo Mandalá, “Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike”, 2022 (670 faqe dhe 247 dokumente origjinale).

3. Virgjil Kule, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Kryqtari i fundit”, botim i vitit 2012 (507 faqe).

4. Blerina Suta, “Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)”, botim i vitit 2016 (126 faqe).

5. Irakli Koçollari, “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës” (vol. I-IV), 2019-2023 (2454 faqe dhe 1037 dokumente origjinale).

6. Ermal Nurja, "Vlora në dokumentet osmane të arkivës së Stambollit", 2023, (359 faqe, një katalog albanologjik i plotë).

7. Lida Miraj, "Albania through Traveller's Eyes" (from the Age of Humanism to the end of War World II), botim i vitit 2022, (490 faqe, e gjitha e shkruar në anglisht).

8. Lucia Nadin, "Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XIV me shtesat deri më 1469, 2022 (254 faqe).

Në përmbyllje të fazës së dytë të vlerësimit, veprat e nominuara për çmimet fituese, janë:

1. Luccia Nadin, "Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XIV me shtesat deri më 1469, botim i vitit 2022.

2. Mateo Mandalá, "Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike", 2022

3. Irakli Koçollari, "Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës" (vol. I-IV), 2019-2023.

4. Ermal Nurja, "Vlora në dokumentet osmane të arkivës së Stambollit", 2023

5. Blerina Suta, "Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)", botim i vitit 2016.

Votimi për çmimet fituese në Juri u zhvillua me datën 20.12. 2023, që përmbylli fazën e tretë të vlerësimit.

Dhënia e çmimeve:

Çmimi i dytë, shkon për veprën "Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës" (vol. I-IV), me autor Prof. dr. Irakli Koçollari:

Çmimi i dytë, shkon për veprën Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike, botim kritik i dorëshkrimeve, me autor Akad. Matteo Mandalá:

Çmimi i parë, shkon për veprën Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XIV me shtesat deri më 1469, me autor Prof. Lucia Nadin

Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt ceremonia për çmimin e veçantë “Shuteriqi”, që akordohet për botimet dokumentare-burimologjike më të suksesshme, për historinë, gjuhën, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin shqiptar



-Etleva Domi prezanton vlerësimet për veprat e nominuara “Vlora në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit” me autor dr. Ermal Nurja dhe “Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622) me autore dr. Blerina Suta

-Akad. Hoxha, në fjalën e hapjes, thekson se Akademia e Shkencave po rivlerëson me objektivitet të gjitha botimet dokumentare historike

Ceremoninë për çmimin e veçantë “Shuteriqi”, që akordohet për botimet dokumentare-burimologjike më të suksesshme, për historinë, gjuhën, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin shqiptar e çeli akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike.

Akad. Hoxha përshëndeti Kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin dhe foli për rëndësinë e këtij çmimi. Ai theksoi se Akademia e Shkencave, po rivlerëson me objektivitet të gjitha botimet dokumentare historike, për të motivuar punën shumë të vlefshme në këtë drejtim.

Konkursi i hapur nga Akademia e Shkencave për çmimin “Shuteriqi” u shpall në

kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare “Shteti i Arbërit dhe Arbëria në shekujt e humanizmit evropian”, që u organizua dhe zhvillua me shumë sukses, me rastin përkujtimor të 555-vjetorit e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, me 8-10 tetor 2023, në Gëziq të Mirditës dhe këtu në Akademinë e Shkencave.

Çmimi i veçantë “Shuteriqi”, akordohet për botimet dokumentare-burimologjike më të suksesshme, për historinë, gjuhën, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin shqiptar; për vepra të tilla të realizuara që nga viti 2001 deri në vitin 2023.

Akad. Hoxha tha se emri i këtij çmimi, është emri i një personaliteti shumë të shquar të letrave, krijimtarisë dhe kulturës shqiptare, Dhimitër Shuteriqit, si shkrimtar dhe historian i letërsisë, si poet, prozator, studiues, hulumtues i dalluar, hartues tekstesh shkollore, publicist, profesor, dhe akademik. Si shkencëtar, fusha kryesore e punës së tij, gati 60- vjeçare, deri në ditët e fundit të jetës, kanë qenë fillimet e qytetërimit shqiptar, historia e letërsisë, tradita e hershme e shkrimit të shqipes, studimet letrare-monografike, studimet dokumentare dhe folklorike nga fusha e albanologjisë në tërësi.



Më tej akad, Hoxha foli për vlerën e pamohueshme të dokumentacionit dhe trashëgiminë që na kanë lënë personalitetet e shkencës Injac Zamputi, Vexhi Buharaja, Henrik Lacaj, Koço Bozhori, Theofan Popa, Filip Liço, Hamdi Bushati, Jonuz Tafilaj, Pashk Gjeçaj, Kolë Luka, Gjon Shllaku, Isuf Vrioni, Selami Pulaha dhe shumë të tjerë dhe vuri në dukje se është rasti të evokojmë me nderim të thellë të gjithë ata që punuan e punojnë me dedikim e devocion në fushë të mendimit e të kërkimit: transkriptuesit e

mirënjohur Injac Zamputi e Koço Zheku; filologët Francesco Altimari e Matteo Mandalà, dhe, me plot meritë, profesoreshën e nderuar Lucia Nadin, rizbuluesen e Arbërit europian, tani së fundi edhe rizbuluese e dorëshkrimeve të panjohura të Marin Barletit. ...Për këto dorëshkrime të panjohura, Akademia e Shkencave po bashkëpunon me sukses për promovimin e integrimin e tyre në trashëgiminë europiane...”

Vëmendja e Akademisë së Shkencave do jetë në nxitjen e mëtejshme të kërkimit shkencor në fushat e albanologjisë, duke vlerësuar gjithnjë në masën e duhur dhe në mënyrë të denjë, punën dokumentuese shkencore, që gabimisht është këndvështruar si një “punë për të tjerët”.

Zbulimet arkeologjike dhe antropologjike të reja, kërkimet e dokumenteve të reja në arkiva, shqipërimet e tyre nga greqishtja, latinishtja, apo versionet gjuhëve e mesjetare ballkanike, do të mbeten ambicie konstante e kërkimeve dhe studimeve të mëtejshme.

Dr .Etleva Domi prezantoi vlerësimet për veprat e nominuara:

1- “Vlora në dokumentet osmane të Arkivit të Stambollit” (Udhërrëfyes) botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2023, 359 faqe.

Pjesë e projektit që synon përgatitjen dhe botimin në shqip të udhërrëfyesve për dokumentet osmane, që gjenden në fondet e ndryshme të arkivave të Stambollit për territorin e Republikës së Shqipërisë, ndarë sipas qendrave administrative të dikurshme.

Përfshin dokumentet dhe regjistrat osmanë që kanë të bëjnë me qytetin dhe fshatrat që vareshin administrativisht nga nënprefektura e Vlorës, që u përkasin periudhës klasike (1431-1837) dhe asaj moderne (1839-1912) të Perandorisë Osmane.

Përzgjedhur, sistemuar, klasifikuar, përgatitur, shqipëruar, shoqëruar me fjalorth shpjegues nga osmanologu dr. Ermal Nurja.

Arritje e suksesshme e një pune të madhe, serioze, të palodhur hulumtuese, të lavdërueshme për prurje dokumentesh e indikacione arkivore me interes për historinë e Shqipërisë në periudhën osmane, si dhe për ofrimin e një informacioni të pasur për ngjarje, fakte e personazhe të jetës politike, ekonomike, kulturore, fetare dhe administrative të trevës së Vlorës; përshkrim i përimtuar profesional i dosjeve simbas stadarëve bashkëkohore të arkivistikës; indikacione arkivore për nënprefekturën e Vlorës, por tematikisht me një karakter gjithëpërfshirës; botim i dobishëm informues dhe orientues për botën akademike: historianë, studiues, arkivistë, dokumentalistë etj., dhe jo vetëm.

Kjo vepër, - pjesë e një kolane të vëllimshme, - është një nxitje për hulumtime të mëtejshme, si dhe punime shkencore të thelluara, teza doktoraturash, organizime tryezash të rrumbullakta etj. mbështetur në dokumentacionin e larmishëm arkivor që ky

botim sjell.

2-“Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622), botuar nga Shtëpia Botuese “Onufri”, 2016, 126 faqe.



Studim kërkimor-shkencor me interes filologjik i veprës së njohur Dottrina Christiana të autorit të letërsisë së vjetër shqipe Pjetër Budi, rrethanave të botimit të veprës dhe të zhvillimit të veprimtarisë së tij, ku botohet një material gjuhësor i panjohur më parë, sillen të dhëna të reja për një ekzemplar të rrallë, që përmban faqe të panjohura më parë, një fashikull (fashikulli “A”) të ndryshëm nga botimi original i veprës/kopjes së njohur Dottrina Christiane (1618).

I gjetur/i zbuluar nga studiuësja Dr. Blerina Suta gjatë hulumtimeve që ajo ka realizuar në bibliotekën “Angelica” të Romës, botim që ndriçon një aspekt të panjohur të veprës së Budit, pasi të gjitha punimet e deritanishme janë bazuar në ekzemplarin e vetëm që ruhet pranë Bibliotekës Apostolike të Vatikanit, një riprodhim fotografik i së cilës ruhet edhe në koleksionet e rralla të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Studim serioz i veprimtarisë së Budit parë në një rrafsh të gjerë; analizë e mirëfilitë tekstore e faqeve të panjohura më parë; interpretime të spikatura filologjike të mbështetura edhe në studime shkencore të mëparshme të albanologëve “të zëshëm” shqiptarë apo të huaj, përfshirë edhe Shuteriqin, Çmimi me emrin e të cilit na ka mbledhur të gjithëve sot; përshkrime bibliografike sipas standardeve bashkëkohore të

ekzemplarit të njohur e atij të zbuluar; fryt i një pune këmbëngulese të kërkimeve në bibliotekat dhe arkivat e Romës, si dhe shfletimit të një arsenali të pasur bibliografik.

Studimi monografik është një vlerë e shtuar në studimet tona filologjike; përbën jo vetëm një kontribut në shkencën e albanologjisë, por, shërben edhe si një shtysë për studime më të thelluara me dokumentet arkivore të panjohura deri më sot, që kjo studiuese me kulturë e horizont të gjerë komunitetit akademik i ofron.



Fitues të Çmimit “Shuteriqi” janë:

Çmimi i parë, Luccia Nadin, “Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shek. XIV me shtesat dero më 1469,botim i vitit 2022.

Çmimi I dytë, Mateo Mandalá, “Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike”, 2022.

Çmimi I dytën Irakli Koçollari, “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali Pashë Tepelenës” (vol. I-IV), 2019-2023.

Çmimi i dytë jepet për veprën “Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike, botim kritik i dorëshkrimeve”, me autor akad. Matteo Mandalà (bot. "Ombra GVG")

Çmimi i dytë
Për veprën Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike



Motivacioni:

Botim kritik i dorëshkrimeve të shkrimtarit arbëresh të shek. XVIII Nikollë Filja / Nicolò Figlia: Kodiku i Kieutit (Codice Chieutino) dhe Vajtim’ i zonjësë Shën Mëri Virgjërë mbi malt Kalvarie

Pjesë e projektit Beta: Biblioteka elektronike e teksteve arbëreshe, që realizohet prej tri dekadash nga albanologët arbëreshë të Universitetit të Kalabrisë dhe të Universitetit të Palermos

Me 247 dokumente që bëhen të njohura për herë të parë në tërësinë e tyre.

Përzgjedhur, renditur, tejskruar, pajisur me aparat kritik dhe me shenjime gjuhësore, historike e kulturore nga Matteo Mandalà

Kurorëzim i suksesshëm i një ndërmarrjeje shkencore shumëvjeçare në fushë të gjurmimeve filologjike mbi letërsinë arbëreshe të shek. XVII-XVIII; pjesë përbërëse e korpusit më të rëndësishëm të botimeve kritike-filologjike të kësaj letërsie

katërshekullore; një model ekdotik për procesin e ndërlikuar të kalimit nga dorëshkrimi në botim, që synon e realizon ringjalljen me besnikëri të vullneteve autoriale të veprave të mbetura mënjanë në arkiva e biblioteka; shprehëse e formimit cilësor të shumanshëm dhe njohjes së thelluar gjuhësore, historike, kulturore dhe fetare të periudhës historike; përfaqësuese dinjitoze e shkollës së sotme të filologjisë dhe të gjetetikës së tekstit për burimet e hershme arbëreshe dhe shqiptare.



Çmimi i dytë jepet për veprën “Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës” me autor Irakli Koçollari

Çmimi i dytë

“Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës”

Në katër vëllime, botuar ndërmjet viteve 2016-2022



Motivacioni:

Burime parësore arkivore e bukinistike për figurën komplekse Ali pashë Tepelenës e raportet e tij me kryeqendrën perandorake dhe me përfaqësues të shteteve të Perëndimit; për Pashallëkun e Janinës dhe format e organizimit parashtetëror të shqiptarëve; për pozitën e tyre në kuadër të supershtetit osman, të zotërimeve të Ali pashës dhe pashallëqeve të tjera, si dhe me fqinjët jugorë

Koleksioni më i vëllimshëm e më i rëndësishëm i dokumenteve të botuara në shqip për figurën e Ali pashë Tepelenës, si protagonist i zhvillimeve historike shqiptare,

ballkanike, perandorake e europiane përgjatë shek. XVIII e në vijim; me burime arkivore osmane, greke, franceze, britanike, italiane, amerikane dhe prej gjuhësh të tjera, të mbledhura me një vullnet të jashtëzakonshëm dhe të përgatitura me përgjegjësi shkencore për botim; që në pjesën më të madhe të tyre bëhen të njohura për herë të parë; të vlerësuara për ndikimin e drejtpërdrejtë në historiografinë shqiptare lidhur me personalitetin e Ali pashës, veçmas për identifikimin dhe përcaktimin etnik e fetar të vetes dhe të popullit shqiptar; për ndikimin që pati në dobësimin e perandorisë osmane e inkurajimin e kombëtarizmit në Ballkan; për lidhjet e tij me mbretëritë perëndimore dhe rolin që luajti për të bërë të njohur mes tyre ç'ishin e çfarë meritonin shqiptarët.



Çmimi i parë jepet për veprën “Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shekullit XIV, me shtesat deri më 1469” me autore Lucia Nadin

Çmimi i parë

Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shekullit XIV, me shtesat deri më 1469”
Botuar tri herë: italisht (2002) dhe shqip (2010, 2017)

Zbuluar në Museo Correr të Venecias nga Lucia Nadin;

Përgatitur për botim nga Lucia Nadin;

Me bashkëpunimin e Giovan Battista Pellegrinit, Gherardo Ortallit dhe Oliver Jens Schmitt-it;

Përkthyer shqip nga Pëllumb Xhufi

Nën kujdesin, drejtimin dhe autoritetin shkencor të Lucia Nadin



Motivazioni

Zbulimi më i rëndësishëm dokumentar i dy dekadave të fundme për arbërit dhe Arbërinë përgjatë shekujve të humanizmit europian; dëshmi historike parësore me ndikim të fuqishëm për ndryshimin e imazhit të shqiptarëve në historinë botërore të kësaj periudhe, për tipologjinë e qytetërimit dhe kulturës së tyre; për rendin dhe

organizimin shoqëror në botën shqiptare deri në fundin e Mesjetës, si një vend që zhvillohej sipas modelit të republikave të Perëndimit dhe hap më hap me gjithë hapësirën adriatike; pasqyrë e një fisnikërie vendëse që ishte e denjë për të kaluar prej identifikimit patronimik në atë etnik e kombëtar; përgatitur për botim në italisht e shqip nga një skuadër albanologësh të mirënjohur, nën kujdesin, drejtimin e autoritetin e saj shkencor.

Primo premio

Motivazione primo premio assegnata all'opera "Statutet e Shkodrës, nga gjysma e parë e shekullit XIV, me shtesat deri më 1469" (Gli Statuti di Scutari, dalla prima metà del secolo XIV, con appendici fino al 1469) pubblicato tre volte: in italiano (2002) e in albanese (2010, 2017), scoperta nel Museo Correr di Venezia da Lucia Nadin; con la collaborazione di Giovan Battista Pellegrini, di Gherardo Ortalli e di Oliver Jens Schmitt; tradotto in albanese da Pëllumb Xhufi; dietro cura, direzione e autorità scientifica di Lucia Nadin.



Si tratta della più importante scoperta documentaria degli ultimi due decenni sull' Arbëria e gli arbër nel periodo dell'umanesimo europeo; di un' importantissima testimonianza che ha influito in modo sensitivo nel cambiare l'immagine sugli albanesi

nella storia mondiale di questo periodo; sulla tipologia della loro civiltà e della loro cultura; che riflette l'organizzazione sociale nel mondo albanese fino al tardo medioevo, come un paese che era in via di sviluppo secondo i modelli europei occidentali e di pari passo con tutta l'area adriatica; che è riflessione dell'esistenza di una nobiltà genuina che era degna del passaggio da un'identificazione patronimica a quella etnica e nazionale; curata per l'edizione a stampa da un'equipe di celebri studiosi di albanologia, dietro la cura, direzione e autorità scientifica di Lucia Nadin.



Institutet e albanologjisë fillojnë veprimtarinë si njësi kërkimore-shkencore të përhershme pranë ASHSH



- E para reformë institucionale që synon rritjen e efektivitetit e bashkëpunimin ndërinstitutional e jo reduktim e shkurtime të kapaciteteve e punonjësve kërkimorë-shkencorë

- Me ribashkimin u arrit çka ishte dëshiruar në realizim të fazës së dytë të reformës së ndërmarrë nga ASHSH

- Institutet e albanologjisë, pas disa reformave të dështuara, nuk mund të qendronin në paqartësi ligjore: as institucione të arsimit të lartë, as institucione kërkimore

- Fuqizimi i albanologjisë është një kërkesë që vjen nga vetë misioni kryesor për të cilin u themelua Akademia e Shkencave e institutet përkatëse

- Institutet dhe Akademia janë të pandashëm: vendimet e Qeverisë janë dëshmi e rritjes së vëmendjes dhe përgjegjësisë së ekzekutivit për kërkimin shkencor dhe korrigjojnë mosveprimin e tij vite më parë

- Tre projektet madhore në albanologji i kanë paraprirë procesit të ribashkimit si një proces i natyrshëm e i domosdoshëm.

Akad. Skënder Gjinushi dhe Kryesia e Akademisë së Shkencave zhvilluan dhe e sot disa takime e bashkëbisedime njohëse me punonjësit kërkimorë-shkencorë dhe drejtuesit e përkohshëm të Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Historisë, Institutit të Gjuhësisë dhe

Letërsisë, Institutit të Antropologjisë, Qendrës së Studimit të Arteve dhe Qendrës së Botimeve Enciklopedike e Albanologjike.



Akad. Gjinushi u bëri të njohur të pranishmëve aktet e miratuara nga KM, Asambleja dhe Kryesia për të realizuar ngritjen e instituteve të albanologjisë si njësi kërkimore të përhershme të vijës së parë, siç e kërkojnë shkencat e identitetit, prioritet themelor në strategjinë e zhvillimit të ASHSH dhe të sistemit të kërkimit shkencor të vendit.



Ashtu siç është parashikuar në këto akte, ndërprerja e mënyrës së mëparshme të organizimit dhe kalimi i instituteve të albanologjisë prej një varësie në linjë administrative në përbërje të rrjetit të ASHSH, përkundër sa është thënë ndonjëherë, jo vetëm nuk e cenon, por e zgjeron dhe fuqizon autonominë akademike. Organet drejtuese të njësive: këshilli shkencor e drejtori, kanë tërë hapësirën e nevojshme për organizimin e realizimin e kërkimit shkencor të programuar; përbërja e këshillave shkencorë nga dy të tretat me anëtarë të brendshëm dhe një e treta nga radhët e ekspertëve më cilësorë të fushës nuk cenon autonominë e tyre, por mundëson një hapje të instituteve ndaj institucioneve të tjera e komunitetit shkencor, ashtu sikurse komisionet e përhershme të Akademisë kanë rezultuar tepër efektive në këtë drejtim.

Buxheti i njësive do të jetë zë më vete dhe ndarja e tij e sidomos menaxhimi nuk do të bëhet më nga një bord administrimi burokratik, por nga bordi i drejtorëve. "Zëvendësimi" i disa strukturave, si rektorati, bordi i administrimit e senati nga ky bord si organ më tepër harmonizues e koordinues e pikë lidhjeje me Asamblenë e Kryesinë e ASHSH, do të evitojë kontradiktat që vëreheshin shpesh në IAL midis organeve të lartpërmendura.



Statusi dhe trajtimi financiar i tërë kategorive të punonjësve të njësive sipas VKM do të jetë i njëjtë me atë të personelit të IAL-ve, kategoria "universitet". Organika e përgjithshme e punonjësve shkencorë është shtuar me katër vende dhe do të kërkohen ndryshime të reja, p.sh. për specialistë me formim të thelluar, duke përfshirë gjuhët e rralla. Buxheti, ashtu si më parë, do të jetë me grante dhe i trashëgueshëm.

Për mënyrën si do të ishte më mirë të organizoheshin departamentet, duke filluar

prej emërimit të tyre, do të diskutohet deri në fund të muajit tetor. Ndërkohë do të jenë hartuar rregulloret e brendshme për institutet dhe qendrat, të parashikuara në kapitullin e ri të Statutit dhe deri në zgjedhjet e para sipas Statutit do të përcaktohen propozimet për riorganizim të brendshëm të njësive e për përmirësime e plotësime eventuale në Statut.

Kryetari Gjinushi paraqiti me këtë rast drejtuesit e instituteve dhe qendrave te reja; përbërjen e këshillave shkencorë; strukturat, organikat, listat emërore të punonjësve dhe nivelet e pagave të tyre për tre grupet: punonjës kërkimorë-shkencorë, punonjës ndihmës tekniko-shkencorë dhe të administratës ndihmëse.



Drejtuesit e instituteve: akad. Adem Bunguri (IA); prof. dr. Hamit Kaba (IH); akad. Valter Memisha (IGJL); prof. asoc. dr. Olsi Lelaj (I.A.); akad. asoc. Stefan Çapaliku (Q.S.A.) dhe prof. asoc. Marenglen Kasm (QBEA), falënderuan Kryesinë për detyrat që iu mirëbesuan dhe u shprehën optimistë për mbarëvajtjen e punëve në vitin kalimtar në vazhdim e më tej.

Takimi u mbyll me urimin "të na shkojë mbarë".

Në 80-vjetorin e lindjes së shkrimtarit akademik Fatos Kongoli

Takim nderues në sallën “Aleks Buda”, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe shtëpia botuese “Toena”

I pranishëm shkrimtari dhe akademiku Fatos Kongoli, i cilësuar si “shkrimtar i antiheroit”, i cili, në pjesën e dytë të veprimtarisë, bashkëbisedoi me lexues të rinj të shkollave të mesme të kryeqytetit, në përgjigje të interesimit të tyre.



Takimi u hap nga znj. Irena Toçi, drejtore e shtëpisë botuese “Toena”, e cila foli për vendin e letërsisë së Kongolit në letërsinë bashkëkohore shqiptare; origjinalitetin e saj dhe bashkëpunimin e frytshëm shumëvjeçar autor-botues.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave foli sekretari shkencor akad. Shaban Sinani. Në fjalën e tij ai theksoi:

Fatos Kongoli është një personalitet i veçantë, sepse me emrin e të cilit lidhet fort një periudhë letrare-kulturore, periudha e shkrimtarit në liri; e shkrimtarit që e ka që bën qartazi dhe cilësisht dallimin jo vetëm me një kohë që shkoi, por dhe me “vetveten e dikurshme”.

Shkrimtarët që erdhën nga shoqëria e kontrollit ideologjik, kulturor e fetar, një brezni e tërë, të cilën Robert Elsie e quante “gjenerata post-Kadare”; entuziastë si qytetarë për ndryshimet që ndodhën në kapërcyell të dy kohëve, nuk e patën aq të lehtë të përshtateshin edhe në letërsi me rënien e kanoneve. Fatos Kongoli e Zija Çela, Koço Kosta e Xhevahir Spahiu, Bardhyl Londo e Skënder Rusi, qenë nga të paktët “sfidantë të lirisë”,

duke mos hequr dorë, në të kundërtën, duke e vazhduar - me ndonjë përthyerje, por natyrshëm - me një vendosmëri heroike, pasionin e parë, letërsinë, përkundër shumë të tjerëve që heshtën ose u detyruan të ndërronin regjistër shprehjeje.



Brenda këtij grupimi, Fatos Kongoli ka meritën që u nda “me një të qeshur të hidhur” nga e kaluara dhe ndoqi një rrugë tjetër: jo duke e bërë së jashtmi gjyqin e së shkuarës, por duke shkruar letërsi rreptësisht vetëqortuese, autoironike, që merrte shkas nga bota brenda njeriut, brenda autorit; nga depërtimi prapavajtës në imtësitë e jetës së vet si subjekt, sidomos në veset e ligësitë, duke e ftuar lexuesin të shkëputet prej saj përmes pështirosjes, neveritjes.

Vetëzbulimi kritik e i pamëshirshëm, si shprehje e një shkalle shumë të lartë mendësie emancipuese, është një nga arsyet pse letërsia e Fatos Kongolit, me rreth 20 romane e vëllime me tregime, është përkthyer, botuar e ribotuar në disa gjuhë të Botës: në Francë e Itali; në Zvicër, Greqi e Gjermani; në Britani të Madhe e Spanjë; në Serbi, Slloveni e Sllovakia; në Japoni e Kinë; madje dhe në “shpikjen gjuhësore të dr. Esperanto-s”.

Kjo përmasë e tij na jep kënaqësi të pohojmë se në radhët e shkrimtarëve-akademikë prej kohësh kemi tashmë edhe një tjetër autor të ndërkombëtarizuar, Fatos Kongolin - krahas me Ismail Kadarenë, që “e shkeli kufirin” me kohë, prej së hershmi, si një “i arratisur me mend”; krahas me Luan Starovën, që pushon me vend të sigurt midis tri letërsive dhe lexuesve të dy kontinenteve.

Vepra e Fatos Kongolit tërhoqi vëmendjen dhe emocionet e lexuesit shqiptar dhe

atij të huaj për paraqitjen traumatizuese të jetës së njeriut shqiptar në dy periudha: gjatë diktaturës dhe në tranzicion. Përballja e individit me absurdin e jetës, dramën e brendshme të tij; depërtimi në psikikën e njeriut me mendim e ndjenja të ndrydhura; krijimi i antiheronjve jo për kundërvënien kanonike ndaj kultit të mëparshëm të heroit, por si mundësi për të zbritur në të panjohurat tronditëse të qenies njerëzore, përbëjnë risi themelore krijuese të veprës së tij.



Pikërisht për këtë vetëshquarje origjinale, dy vjet më parë, kur Komiteti i Nobelit iu drejtua Akademisë së Shkencave me kërkesën për të bërë jo një, si zakonisht, por katër propozime - një procedurë e re e zbatuar me të gjitha akademitë e ftuara për bashkëpunim atë vit - pra, kur erdhi kjo ftesë e veçantë për të rekomanduar disa kandidatura të denja për konkurrim për çmimin më të rëndësishëm në letërsi në shkallë botërore, ASHSH argumentoi dhe përcolli si një nga zgjedhjet e saj në Akademinë Mbretërore të Suedisë kandidaturën e shkrimtarit-akademik Fatos Kongoli.

Në përputhje me protokollin e letërkëmbimit për nominimet që zbaton Komiteti i Nobelit, që duhet thënë se është shumë i rreptë dhe i kodifikuar, duhej ruajtur konfidencialiteti deri në përmbyllje të konkursit të atij viti. Për këtë shkak - duke qenë pak të padrejtë me mikun dhe kolegun tonë Fatos Kongoli - për këtë arsye burokratike pra, ky vlerësim i lartë institucional nuk i është bërë i ditur deri sot atij (dhe as publikut). Por sot, që ka kaluar koha e ruajtjes së confidences, mund ta pohojmë e ta parafranojmë.

Në politikën e Akademisë së Shkencave është zgjedhje parimore që, kurdoherë që

drejtohen ftesa për të promovuar ndërkombëtarisht figura të shkencës dhe kulturës kombëtare, vlerësohen e propozohen si kandidatë personalitetet më të shquar në fushat e dijes dhe krijimtarisë, pa lënë vetë boshllëk. Propozime të ASHSH janë adresuar për çmimin “Feltrinelli”; për çmimin “Madame de Stael”; për vlerësuesit e kërkimit shkencor të “European Research Area” (ERA). Shumë herë propozimet janë mirëpritur prej jurive e komisioneve ndërkombëtare (dy anëtarë të Akademisë janë sot të zgjedhur si vlerësues projektesh ndërkombëtare të ERA-s); natyrisht jo gjithnjë duke fituar, por më së pari duke u promovuar. Kandidaturat, fituese a jofituese, studiohen e vlerësohen prej jurive e bordeve; njohja e tyre në mjediset shkencore e krijuese zgjerohet. Kështu është vepruar edhe në rastin e ftesës së komitetit të Nobelit. Krahas Kadaresë, që propozohet çdo vit jo vetëm nga ASHSH, por edhe nga akademi të tjera, atë vit u regjistruan edhe kandidaturat e Fatos Kongolit, Luan Starovës e të arbëreshit Carmine Abate, aktualisht fenomen i letërsisë italiane.



Në argumentin për kandidaturën e Fatos Kongolit ndër të tjera thuhet: Boshti i gjithë krijimtarisë së këtij autori është kriza ekzistenciale e njeriut si qenie individuale e kolektive. Paradokset njerëzore; ironia e idhët ndaj realiteteve të kaluara dhe situatave absurde; synimi për ta shkundur njeriun në tronditjen e krizës së identitetit; ndonëse aspak të lara me optimizëm, nuk e bëjnë të ashpër letërsinë e tij; përkundrazi, duke depërtuar në fshehtësitë e shpirtit njerëzor, shpërfaqen humanizmi dhe dashuria njerëzore, që, sipas autorit, janë shpëtimi i njeriut në çdo kohë. Skutat dyfish të errëta të mendjes njerëzore, për shkak të komplekseve e psikozave të përgjithshme dhe të dobësive vetjake, që gjenden në romanet e tij, kanë bërë që shtypi francez t'i cilësojë ato

si një ndërthurje e teknikave të të shkruarit të Dostojevskit dhe Beckett-it. Romanet e Kongolit janë shpresë e nxitje e perspektivës së prozës moderne shqiptare. Ndryshe prej një tradite të mbrapshtë refuzuese ballkanike ndaj fqinjit, duke përfshirë “kufirin gjuhësor”, ai është pritur shumë shpejt si një mik i denjë edhe në letërsinë e rajonit, përveç sa u përmend, edhe në Bullgari, Rumani, Turqi dhe Greqi.

Presidenti i mëparshëm i Francës Nikolas Sarkozy, duke i dorëzuar Fatosit Kongolit “Urdhrin e Kalorësit të Legjionit të Nderit”, qe shprehur: “Vendi im njih në të gjitha kuptimet e fjalës madhështinë e veprës suaj, sepse të bësh letërsi nga një akt vuajtjeje dhe vetmie është tejet e vështirë”.

Akademia e Shkencave është propozuese si institucion e Kongolit për vlerësimin më të lartë në letërsi, por jo e vetmja, sepse në po atë rast, presidenti Sarkozy është shprehur:

“Për shumë vlera të përmbajtjes, por edhe të eksperimentimit romanor, ju sugjeroj, të nderuar zotërinj të Komitetit të Nobelit, ta merrni në konsideratë të posaçme letërsinë e shkrimtarit shqiptar Fatos Kongoli”.

Takim këshillues i Kryesisë me drejtorët e instituteve të albanologjisë dhe kryetarët e komisioneve të përhershme

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i ASHSH, i njohu të pranishmit me qëllimin e këtij takimi: përgatitja e raportimit vjetor në Asamble dhe e programit për vitin 2024 me përfshirjen e raporteve dhe propozimeve të instituteve.

Në lidhje me projektet për vitin 2024 (botime, konferenca, projekte) Kryetari Gjinushi tha se nismat shkencore afatgjata të instituteve (kërkime arkeologjike dhe arkivore, ekspedita etj.) do të vazhdojnë të kenë mbështetje.



Propozimet e instituteve dhe qendrave kërkimore do të paraqiten në komisionet e përhershme, ku do të bëhet edhe adresimi i tyre si veprimtari të nivelit të Akademisë, të institutit apo departamentit. Më tej do të identifikohen projektet ndërinstitutionale.

Kryetari Gjinushi u bëri të ditur të pranishmëve se buxheti i vitit 2024, ashtu siç ishte kërkuar, është parashikuar veçmas atij të ASHSH dhe shumë shpejt bordi i drejtorëve do të konstituohet e do të mbledhet për detajimin e tij në përputhje me rëndësinë e projekteve të propozuara nga institutet.

Ai theksoi rëndësinë e projekteve afatgjata dhe u kujtoi drejtuesve të instituteve mundësitë e mëdha për aplikime të suksesshme në kuadër të projekteve shkencore dhe teknologjike të AKKSHI-it, thirrja e parë e së cilës është tashmë publike; si dhe në kuadër të projekteve europiane dy- e më shumëpalëshe.

Analiza vjetore e punës për vitin 2023 dhe programi për vitin 2024 do të paraqiten me një dokument të përbashkët, në muajin shkurt.

Drejtuesit e instituteve dhe të komisioneve: Adem Bunguri, Stefan Çapaliku,

Hamit Kaba, Valter Memisha, Olsi Lelaj, Neritan Ceka, Anastas Angjeli, Jorgaq Kaçani, morën pjesë me sugjerime në këtë takim këshillues.



Shpallet Konkursi për për ringritjen e Akademisë së të Rinjve dhe për pranimet e reja sipas Ligjit e Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pas miratimit Kartës Themelore të Akademisë së të Rinjve nga Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më datë 16 nëntor 2023, me vendimin nr. 64, referuar nenit 5 pika ç dhe nenit 20 të Ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 47 të Statutit të saj, si dhe mbështetur në frymën e Kartës Themelore për Akademitë e të Rinjve, miratuar nga ALLEA dhe miratuar për vendin tonë nga Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pasi konstatoi se Akademia e të Rinjve të Shqipërisë është ngritur me një akt nënligjor (vendimi nr. 14 datë 07.06.2017 i Kryesisë) dhe jo referuar ligjit në fuqi për Akademinë e Shkencave; si dhe se pjesës më të madhe të anëtarësisë së deritashme të saj i ka mbaruar mandatet, shpall konkursin për ringritjen e Akademisë së të Rinjve dhe për pranimet e reja sipas Ligjit e Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Komisioni për pranimin e anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjve do të ketë në përbërje shtatë anëtarë: akad. asoc. Adrian Civici, akad. Aurela Anastasi, akad. asoc. Fatbardh Sallaku, akad. Ilirjan Malollari, akad. asoc. Kristina Jorgaqi, akad. asoc. Kozeta Sevrani dhe akad. asoc. Mimoza Hafizi.

Takim në ASHSH i komisionit të posaçëm të ngritur nga Kryesia e ASHAK-ut për themelimin e Akademisë së të Rinjve të Kosovës



Përfaqësuesit e ASHAK-ut, të ngarkuar për hartimin e dokumenteve të themelimit të Akademisë së të Rinjve të Kosovës: akad. Justina Shiroka-Pula, akad. korresp. Gjyljeta Mushkolaj, akad. korresp. Myzafere Limani dhe znj. Lendita Pula, sekretare e ASHAK-ut; u takuan sot me anëtarë të Kryesisë së ASHSH, pranë së cilës Akademia e të Rinjve ekziston që nga viti 2017 dhe tani është në një proces ringritjeje.

Akad. Vasil S. Tole - zëvendëskryetar dhe Shaban Sinani, sekretar shkencor; bënë të njohur historikun e ngritjes dhe funksionimit të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë, fillimisht me një vendim të Kryesisë dhe me kriter përzgjedhjeje fituesit e çmimit shkencor për të rinjtë.

Statusi i Akademisë së të Rinjve, i barabartë me atë të një komisioni të përhershëm, u përcaktua me Ligjin 53/2019; më pas u specifikua në Statutin e ASHSH. Kjo arsye ligjore, si dhe kalimi i kufirit moshor mbi 40 vjeç nga shumica e anëtarësisë së mëparshme (anëtarësia në akademitë e të rinjve është status shkencor-moshor dhe jo shkallë rishtarie), një standard ky i gjithëpranuar nga akademitë anëtare të ALLEA-s, bënë të nevojshme ringritjen e saj mbi një bazë të re juridike.

Mbështetur në "Kartën themelore" të miratuar nga ALLEA për akademitë e të rinjve dhe raportet e tyre me akademitë anëtare të saj; duke njohur e krahasuar variantet e përshtatura të këtij dokumenti nga vende të ngjashme në madhësi e fuqi shkencore, u hartua statuti i ri i Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë, që u miratua nga Asambleja.

Statuti përcakton kriteret-kusht për konkurrim e anëtarësim në Akademinë e të Rinjve, si numri i përgjithshëm i anëtarëve (jo më shumë se 20); kufiri moshor maksimal për mandat (jo më shumë se 40 vjeç); grada "doktor i shkencave" (por jo më herët se para

dhjetë vjetësh); certifikimi prej njësisë së formimit bazë (departamenti); shquarja me punime shkencore të vlerësuara; letrat e referencës nga ekspertë të fushës etj. Veç tyre ka dhe kritere që jo domosdoshmërisht duhen plotësuar.

Akademia e të Rinjve gëzon të drejtën e një buxheti vjetor për botimin e një reviste të numerizuar, për pjesëmarrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare e brenda vendit, si dhe për koordinim të punës së saj.



Me aprovimin e statutit, ASHSH miratoi përbërjen e komisionit të pranimit, me funksionet e një jurie, dhe iu drejtua të gjitha universiteteve publike dhe atyre jopublike me të cilat ka marrëveshje, për të nxitur pjesëmarrjen në konkurs. Deri në fund të shkurtit pjesa e parë e anëtarësisë do të jetë miratuar në Asamble.

U theksua nevoja e anëtarësimit në "Global Young Academies" dhe në ALLEA (seksioni përkatës), si dhe rëndësia përparësore që i jepet sot raportit midis akademizmit dhe brezave të rinj.

Nga anëtarët e komisionit të posaçëm të ASHAK-ut u përmendën disa asimetri në organizim e strukturë, si mungesa e komisioneve të përhershme (me mundësi referimi tek seksionet); përfaqësimi i krijuesve (si akademi "edhe e arteve"); raportet specifike me universitetet etj.

Komisionit të ASHAK-ut iu vunë në dispozicion dokumentet bazë të Akademisë së të Rinjve të Shqipërisë: Karta themelore europiane e akademive të të rinjve (e miratuar nga Asambleja si statut i saj); thirrja publike për anëtarësim; vendimi për ngritjen e komisionit pranues; kalendari dhe letra zyrtare drejtuar rektorëve të universiteteve.

Në përfundim u theksua se vendosja e një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë midis dy akademive të të rinjve do të jetë me shumë dobi jo vetëm për to, por edhe për bashkëpunimin ASHAK-ASHSH.

Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike sot në raportimin e veprimtarisë vjetore

Disa të dhëna përmbljedhëse:

I. Projekte madhore në albanologji që zbatohen nga SSHSHA dhe bashkëpunëtorët e tij:

- Histori e shqiptarëve (vit përmbyllës);
- Fjalor i madh i gjuhës shqipe (vit përmbyllës);
- Enciklopedia shqiptare (vit i stabilizimit të redaksive të të tre niveleve);
- Mbi 200 studiues të përfshirë vetëm në nivel redaksie të tre projekteve së bashku.



II. Veprimtaritë shkencore kryesore të SSHSHA dhe komisioneve e njësive (mbi 90 gjatë vitit, pa tryezat dhe përrurimet):

- Konferencë shkencore ndërkombëtare kushtuar shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri;

- The Albanian language area and its surroundings during Antiquity to the High Middle Ages (konferencë shkencore albanologjike ndërkombëtare, Nurenberg 21-22 prill 2023, organizuar nga dega e albanologjisë në LMU dhe ASHSH);

- Probleme të reja të albanologjisë në kohën e sotme (bashkëpunim me Universitetin e Shkodrës, 25-26 maj 2023);

- Jakov Xoxa shkrimtar dhe studiues (Tiranë - Apoloni 7-8 qershor 2023);

-
- Nga "Shteti i Arbërit" tek Arbëria në shekujt e humanizmit evropian (Tiranë 9-10 tetor);
 - Letërsitë kombëtare në sistemin universitar (14 nëntor 2023);
 - Samiti III i Diasporës - Dita arbëreshe (konferencë shkencore ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, Pallati i Kongreseve, Tiranë 22-23 nëntor 2023);
 - Sfidat e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Kosovë dhe në rajon (komisioni i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike pranë ASHSH, në bashkëpunim me ASHAK-un, sipas protokollit të përbashkët (Prishtinë 6-7 tetor 2023);
 - Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës dhe të Shqipërisë në kuadër të integritimeve europiane (ASHSH dhe ASHAK);
 - Studimet për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore (pjesë e protokollit ASHSH-ASHAK, Prishtinë, më 26-27 tetor 2023).
 - Konferencë shkencore në 75-vjetorin e arkeologjisë shqiptare (komisioni i historisë dhe arkeologjisë).



III. Disa të dhëna statistikore

- U organizuan 12 konferenca në nivel të ASHSH (9 ndërkombëtare dhe 3 kombëtare);
- U organizuan 9 konferenca në nivel të SSHSH (2 ndërkombëtare dhe 7

kombëtare);

- U bënë 14 promovime botimesh shkencore (pa ato të panairove të përvitshme në Tiranë, Prishtinë, Ulqin e Tuz);

- U organizua panairi i dytë i librit shkencor dhe akademik në Prishtinë (24-26 prill 2023);

- U mbajtën 4 ligjërata të hapura (Roberto Tottoli, A. Paci, Maria Todorova, B. Kabashi);

- U përgatitën procedurat dhe u bënë certifikimet dokumentuese për zgjedhjen si anëtarë të jashtëm të 3 studiuesve nga Kosova (M. Kraja, S. Hamiti, F. Krasniqi); për zgjedhjen si anëtar nderi të 2 studiuesve të huaj (G. Haug dhe Ke Jing), si dhe për dhënien e titullit "Nderi i Akademisë" J. Xoxës (pas vdekjes);

- U organizua dhe realizua me sukses konkursi për çmimet e veçanta "Shuteriqi";

- Nga anëtarët e SSHSHA janë botuar 22 monografi e 65 artikuj shkencorë dhe janë paraqitur 107 kumtesa apo referime ne konferenca të niveleve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare (pa raportimet vjetore vetjake).



IV. Konferenca të tjera të bashkorganizuara:

- Veçori të luftës antifashiste në krahinën e Skraparit (ASHSH - bashkia e Skraparit, 20 janar 2023);

- Asdreni - në 150-vjetorin e lindjes (ASHSH - Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", 26 janar 2023);

- Konferenca IV Muzeut të Bankës së Shqipërisë "Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar" (ASHSH, bashkorganizatore, 8 shkurt 2023);

-
- Çështje të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit rezilient të territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare (Universiteti "Polis" dhe ASHSH, 13-14 tetor 2023);
 - Shqipëria dhe Turqia, ngritja e një partneriteti strategjik - 100 vjet marrëdhënie diplomatike;
 - Konferencë shkencore ndëruniversitare "Arbëreshi shkodran Leonardo de Martino" (Nj.K-S.A.A.A, ASHSH, Universiteti i Shkodrës, 15.12.2023).
 - Stefanaq Pollo, akademiku, historiani, drejtuesi, njeriu (ASHSH, 14 dhjetor 2023).

V. Disa nga tryezat shkencore, forumet, debatet:

- Skënder Drini, individualitet i spikatur në letërsinë shqipe (3 korrik 2023);
- Nga rilevimi morfometrik tek projekti i restaurimit, me objekt specifik ndërtesën e Akademisë së Shkencave (bashkëpunim me Universitetin e Firences dhe Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë", 30 qershor 2023);
- Vehbi Bala në 100-vjetorin e lindjes, SSHSHA dhe komisioni i gjuhës dhe i letërsisë.

VI. Disa nga përrurimet më të rëndësishme:

- "Ditari i tranzicionit", me 8 vëllime, nga akademik Anastas Angjeli (12 prill 2023);
- "Fjalor serbisht-shqip" me 80 mijë fjalë i Rexhep Zllatkut (6 qershor 2023), komisioni i gjuhës dhe i letërsisë;
- "Fjalor i emërtimeve të njerëzve sipas tipareve fizike e morale në gjuhën shqipe" (15 nëntor 2023, komisioni i gjuhës dhe i letërsisë);
- "Antologjia e kompozitorëve të rinj kosovarë"; komisioni i përhershëm i artit dhe trashëgimisë kulturore.

Takim në Kryesinë e ASHSH i kryeredaktorëve të revistave periodike dhe të përmbledhësve - tribuna shkencore të instituteve të albanologjisë

Për nevojën e një politike të përbashkët editoriale



Takimi u zhvillua në zyrën e sekretarit shkencor Sh. Sinani, me praninë e kryetarit të SSHSHA G. Hoxha.

Të pranishëm kryeredaktorët e revistave shkencore "Studime filologjike", "Studime historike", "Iliria", "Antropologji", "Studia albanica", "Albanian studies"; si dhe të përmbledhësve "Studime për artin", "Çështje të folklorit shqiptar", "Dialektologji", "Candavia".

U bënë të njohura shqetësimet e drejtuesve të revistave dhe përmbledhësve, duke nisur prej nevojës së redaktorëve gjuhësorë dhe të përkthyesve, deri tek sigurimi i "open access".

Akad. Valter Memisha kërkoi vlerësimin e mundësisë së ridaljes së periodikut "Gjuha jonë", ndërprerë para disa vjetësh.

Akad. asoc. Stefan Çapaliku u shpreh se është e mundshme që "Studime për artin" të ketë statusin e një periodiku vjetor dhe se cilësia e revistave do të jetë gjithnjë në të njëjtin nivel me atë të kërkimit. Të njëjtin mendim shprehu dr. Elio Hobdari për "Candavia-n", si një tribunë periodike vjetore e profilizuar për raportet mbi rezultatet e

ekspeditave arkeologjike, që është dhe një detyrim ligjor.

Akad. Adem Bunguri vlerësoi traditën e konsoliduar të revistës "Iliria", që ka tashmë edhe praninë e studiuesve të huaj arkeologë, pjesëmarrës në ekspedita arkeologjike të përbashkëta. Prof. dr. Hamit Kaba theksoi se në "Studime historike" tentohet që deri 40 për qind e lëndës të jetë produkt shkencor i historianëve albanologë nga jashtë.

Problemi i ruajtjes së periodicitetit të rregullt si një kusht themelor për indeksim shkencor ndërkombëtar u theksua nga sekretari shkencor i revistës së re "Albanian studies" prof. asoc. dr. Gjon Boriçi. Ndërsa prof. asoc. dr. Mikaela Minga u përqendrua në domosdoshmërinë e aksesit të hapur për të gjitha revistat, duke propozuar ndërtimin e një faqe të numerizuar posaçërisht për to. Këtij mendimi iu përmbajtën edhe kolegët Çapaliku, Hobdari e Lelaj.



Në mënyrë të veçantë u kërkua plotësimi i kushteve të nevojshme shkencore e teknike për kalimin e shpejtë të periodikëve nga lista C në atë B dhe A, sipas përcaktimeve në rregulloren e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Akad. Sh. Sinani dhe akad. G. Hoxha sugjeruan që kryeredaktorët të njiheshin me rregulloren e periodikëve dhe rregulloren e veprimtarisë botuese të ASHSH.

Një problem që kërkon vëmendje të posaçme është profilizimi i revistave me të njëjtin emër në dy gjuhë: "Studia albanica", që del prej 60 vjetësh, dhe "Albanian studies", një revistë e re albanologjike.

Ngritja e një bordi të kryeredaktorëve për të diskutuar e propozuar ndryshimet e mundshme në rregulloret ekzistuese dhe në përbërjen e këshillit të botimeve; ruajtja e autonomisë në vendimmarje për botimet e punonjësve të instituteve por me të njëjtat procedura recensionimi e vlerësimi nga njësi bazë deri në këshill shkencor; mundësia e themelimit të një shtëpie botuese për të realizuar funksionin e ASHSH si ent botues të përbashkët - këto qenë disa nga propozimet që u bënë në takim.

Një këshillim i dytë do të bëhet deri në fund të këtij muaji.



U bë paraqitja e periodikëve shkencorë “Iliria” dhe “Monumentet”, të vitit 2023

- Numri 62 i periodikut shkencor “Monumentet” i kushtohet njëjës prej figurave themelore në fushën e vlerësimit, mbrojtjes, studimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore, ark. Gani Strazimir



Veprimtaria e organizuar nga komisioni i historisë dhe arkeologjisë paraqiti rezultatet shkencore të botuara në këta dy periodikë shkencorë gjatë vitit 2023, në të cilët janë trajtuar edhe aspektet teoriko-metodologjike të mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve.

Takimi u mbajt në praninë e akademikëve dhe studiuesve të instituteteve albanologjike.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i komisionit të përhershëm të historisë dhe arkeologjisë pranë ASHSH, prof. Neritan Ceka.

Prof. Ceka theksoi se studimet duhet të lidhen me problemet e arkeologjisë në terren dhe projektet e kërkimeve arkeologjike të vihen në shërbim të interesave të arkeologjisë shqiptare.

Prezantimi i periodikut shkencor “Iliria” (viti 2023) u bë nga prof. asoc. dr. Belisa

Muka, e cila e përcaktoi këtë revistë si një produkt të mirëfilltë të kërkimeve arkeologjike shqiptare, me një volum të madh dhe larmi tematikash, ku kanë zënë vend monumentet më të rëndësishme të arkeologjisë shqiptare.

Prof. Klesta Qirici, drejtore e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, paraqiti disa çështje për periodikun shkencor “Monumentet” dhe botimet e reja në fushën e trashëgimisë kulturore materiale. Për periodikun shkencor “Monumentet” prof. Qirici përmendi rëndësinë e tij për verifikimin e kriterëve për restaurimin e monumenteve kulturore dhe artit.



Prof. Pirro Thomo prezantoi numrin 62 të periodikut shkencor “Monumentet”, që i kushtohet njërës prej figurave themelore në fushën e vlerësimit, mbrojtjes, studimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore, ark. Gani Strazimirit.

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, e vuri theksin në krijimin e një klime bashkëpunimi ndërmjet studiuesve të Institutit të Arkeologjisë dhe atyre të Institutit të Monumenteve, si dhe të pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta edhe për vitet e ardhshme, duke vënë në shërbim edhe një informacion më të pasur shkencor në këto revista.

Akad. Hoxha vuri në dukje edhe rolin e revistës shkencore “Studia Albanica”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në të cilën përmbledhen artikujt më cilësorë në fushën e studimeve dhe kërkimeve albanologjike.

Në fund u diskutua mbi fushat e bashkëpunimit ndërmjet studiuesve të Institutit të Arkeologjisë dhe atyre të Institutit të Monumenteve përgjatë vitit akademik 2024.



Lectio magistralis "Ndërthurje" nga prof. asoc. dr. Gjergj Prevazi

- Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nis veprimtaritë e para për këtë vit akademik



Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizoi sot, më 31 janar 2024, ligjëratën e hapur (lectio magistralis) "Ndërthurje" nga prof. asoc. dr. Gjergj Prevazi.

Ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari, akad. Vasil Tole, anëtarë të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, artistë të njohur dhe studentë të koreografisë.

Veprimtarinë e hapi akad. asoc. Stefan Çapaliku, drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve. Ai theksoi se përgjatë këtij viti akademik, lectio magistralis do të vijojnë të mbahen në Akademinë e Shkencave nga një në çdo muaj.

Akad. asoc. Stefan Çapaliku vuri në dukje edhe disa nga objektivat që do të ketë Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

"Ndërthurja" u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi mes prof. asoc. dr. Gjergj Prevazit, koreograf, pedagog dhe drejtor i Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" dhe dr. Anxhela Hoxha-Çikopanos (Qendra e Studimit të Arteve).

Koreografi Gjergj Prevazi rrëfeu fillimet e karrierës së tij si pjesë e trupës profesioniste në teatrin “Aleksandër Moisiu” si koreograf i këtij teatri dhe më pas si koordinator në qendrën Ndërkombëtare të Kulturës në Tiranë.

Krijimet koreografike të Gjergj Prevazit janë mbështetur mbi eksperimentet, duke lëvruar për herë të parë në Shqipëri stilin Dance Theatre. Ai ka krijuar e bashkëpunuar me regjisorë të mirënjohur e artistë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, etj, duke i dhënë një shtysë të madhe baletit modern.

Prof. asoc. dr. Prevazi përshkroi filozofinë e krijimtarisë së tij në projektet e shfaqjeve si “Zarabanda” “Tranzicion”, “Kontrast”, “Kumt”, “Këngëtarja tullace”, etj.

Më tej Prevazi rrëfeu përvojën e tij rreth ndikimit që kanë pasur shfaqjet dhe platformat bashkëpunuese artistike në festivale të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.



Gjergj Prevazi tha se dimensionet e artit bashkëkohor janë të pafundme. Ai vuri në dukje se sot nuk mund të imagjinohet dansi brenda disa shtampave të caktuara, ligjeve strikte, por është shumë herë më i hapur. Ai foli për përvojat me studentët, kur u bë pjesë e stafit të pedagogëve në degën e koreografisë pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë, ku mbajti peshën kryesore në katedrën e lëvizjes skenike si shef i kësaj katedre.

Për Gjergj Prevazin, gjuha e trupit, komunikimi joverbal është një komunikim universal dhe si i tillë ai është i pafund. Rikthimet në motivet folklorike dhe në zanafillat e kërcimit njerëzor e kanë pasuruar repertorin e Gjergj Prevazit dhe artin e koreografisë moderne.

In memoriam

Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton me nderim e mirënjohje akademikun Eduard Sulstarova -10-vjetori i ndarjes nga jeta



Në 10-vjetorin e ndarjes nga jeta, Akademia e Shkencave e Shqipërisë kujton me nderim e mirënjohje për veprimtarinë e tij shkencore akad. Eduard Sulstarovën.

Inxhinieri gjeofizikan, profesori dhe akademiku i shquar Eduard Sulstarova (1934-2014) lindi në Korçë.

Shkollën e mesme e kreu në Tiranë. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (1963).

U emërua në katedrën e gjeofizikës në atë fakultet dhe është një nga themeluesit e Shërbimit Sizmologjik Shqiptar. Ka qenë drejtuesi i Stacionit të parë Sizmologjik të Shqipërisë (1968) pranë Universitetit të Tiranës dhe drejtor i Qendrës Sizmologjike të Akademisë së Shkencave, që nga ngritja e saj (1973-1993).

Eduard Sulstarova ka ndërmarrë kërkime e studime për sizmicitetin e vendit e të rajonit, për vlerësimin e rrezikut sizmik në shkallë vendi dhe rajonal etj.

Akad. Sulstarova është autor dhe bashkautor i monografive e librave “Harta sizmike e Shqipërisë” në shkallën 1:1.250.000, “Catalogue of Earthquakes of Balkan Region - Katalogu i tërmeteve të Shqipërisë” (1975), “Rajonizimi sizmik i Shqipërisë - Seismic Hazard of Albania” (1980) etj., si dhe i teksteve “Përdorimi i metodave gjeofizike

për zgjidhjen e detyrave gjeologjike” (1971), “Tektonika dhe rilevimet. Strukturat e thella të kores së tokës” (1983).

Ka botuar një varg artikujsh në revista shkencore. Ka mbajtur ligjërata në disa universitete e institucione shkencore (Japoni, Greqi, Maqedoni, Gjermani). Ka përfaqësuar Shqipërinë në organizmat ndërkombëtarë të sizmologjisë dhe ka qenë Kryetar i Komitetit të Përherëshëm për Pakësimin e Riskut Sizmik në Ballkan (1985–1988), anëtar titullar në Komisionin Sizmologjik European etj. Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1999–2007).

Ka marrë titullin “Punonjës i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës”.